REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 82-të i botimit Nr. 45 (828001) Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes E premte, 13 nëntor 2026



PROJEKTBUXHETI 2027,
76.3 MILIARDË LEKË PËR MBROJTJEN

faqe 3





MINISTRI I MBROJTJES NUFI NË "ATLANTIC FUTURE FORUM 2026": BALLKANI PERËNDIMOR DHE KOSOVA, NË VËMENDJEN E NATO-s

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, po merr pjesë në "Atlantic Future Forum 2026", një prej platformave të rëndësishme të dialogut mbi të ardhmen e sigurisë dhe mbrojtjes euroatlantike, që zhvillohet në bordin e aeroplanmbajtëses britanike HMS "Prince of Wales". Në kuadër të forumit, ministri Nufi zhvilloi takime...

faqe 2



"MBUROJA ILIRE-26", VLERËSIM I KAPACITETEVE TË OPERACIONEVE SPECIALE

Me pjesëmarrjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, përfundoi me sukses stërvitja vetëvlerësuese "Mburoja Ilire-26", e zhvilluar nga Task Grupi i Operacioneve Speciale Tokësore (SOLTG) i Regjimentit të Operacioneve Speciale. Gjatë kësaj stërvitjeje u vlerësuan kapacitetet operacionale të njësisë, niveli i gatishmërisë së efektivave, koordinimi dhe bashkëveprimi ndërmjet strukturave pjesëmarrëse...

faqe 6



DISIPLINA

— *Shka âsht përgjithsisht disiplina.*
— *Disiplina Ushtarake.*
— *Si mësohet disiplina.*
— *Mjete disiplinore.*
— *Nevoja e disiplinës.*

1. — SHKA ÂSHT PËRGJITHSISHT DISIPLINA.

Po të marrim në shqyrtim çdo veprim aktiviteti njerzuer shofim se ky nuk mund të zhvillohet pa atë gjâ që na zakonisht e thrasim *disiplinë* dhe se kjo disiplinë âsht e domosdoshëme që nji i tillë aktivitet të mund të marri qindresë për me i arritë qëllimit për të cillin proponohet.

Eksistojnë kështu disiplina të panjehuna sikurse janë të panjehuna nevojat e njerzve të cilat për me i çue në vënd kërkojnë nji bashkëveprim edhe nji shumsí punimit.

Por të gjitha këto forma disipline kanë nji bazë të vetme: «solidaritet në veprim për qëllimin e përbashkët» me sundue çdo ndiesí ose ambicjon personal para qëllimit që duhet t'i arrihet.



Shum here çuditemi te nutdem me konsiderue hapsin e *botës* edhe arrijmë në përfundimin që në botë gjith çka âsht harmoní e se vetëm për kët harmoní âsht e mundëshëme të zhvilluemit e jetës; shofim edhe se çdo gjâ rregullohet me ligjë, çdo gjâ i përulet ligjëve të caktueme mirë që rregullojnë edhe vënë për fijë ç'do aktivitet e lëvizje.

Shoqnija nuk mund t'i shmanget këtij parimi rregulluës që gjejmë në natyrë, dhe në ç'do mënyrë që kjo shoqëní çfaqet edhe nën çë/do paralel për eksistencën e sajë, ka nevojë për disiplinë: përmbi të gjitha disiplina dhe rregullimi i çfaqjeve shpirtnore të panumërta. Në kët mënyrë janë rregullue, vendue dhe disiplinue përpjekjet e të drejtës ndërmjet qytetarëve me qytetarë dhe ndërmjet qytetarëve me Shtet: në kët mënyrë janë disiplinue nzitjet, karakteret me të çfaqunat e tyne, prirjet dhe instinktet. E që pra se në shoqní rendin e parë e xanë *të drejtat dhe detyrat* me të gjitha përshkrimet dhe përfundimet ndëshkuese që rrjedhin zakonisht.

Kurse flasim për disiplinë nuk duhet të kuptojmë *robni*, por lypset të ndalohemi përkundra

DISIPLINA: FORCA QË E BËN USHTRINË NJË TRUP TË VETËM

Një tekst i vjetër, një mesazh që nuk 'plaket'. Disa shkrime mbeten të lidhura ngushtë me kohën kur janë shkruar, ndërsa të tjerë e kapërcejnë atë dhe vazhdojnë të komunikojnë me të tashmen. Vlera e tyre qëndron pikërisht në aftësinë për të ruajtur aktualitetin edhe pas shumë vitesh, sepse prekin parime dhe vlera themelore të jetës njerëzore e profesionale. Përkushtimi, përgjegjësia, profesionalizmi, disiplina dhe ndjenja e detyrës nuk varen nga koha...

faqe 7

MINISTRI I MBROJTJES NUFI NË "ATLANTIC FUTURE FORUM 2026": BALLKANI PERËNDIMOR DHE KOSOVA, NË VËMENDJEN E NATO-s

Në bordin e aeroplanmbajtëses britanike HMS "Prince of Wales", ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi diskuton mbi sfidat e sigurisë euroatlantike dhe rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, po merr pjesë në "Atlantic Future Forum 2026", një prej platformave të rëndësishme të dialogut mbi të ardhmen e sigurisë dhe mbrojtjes euroatlantike, që zhvillohet në bordin e aeroplanmbajtëses britanike HMS "Prince of Wales".

Në kuadër të forumit, ministri Nufi zhvilloi takime me homologun norvegjez, **Tore O. Sandvik**, si dhe me Nënsekretarin Parlamentar të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, **Lord Wood of Anfield**.

Në qendër të diskutimeve ishin sfidat aktuale të sigurisë euroatlantike dhe nevoja që NATO të ruajë vëmendjen në të gjitha drejtimet strategjike. Gjatë takimeve, ministri Nufi theksoi rëndësinë e Ballkanit Perëndimor në arkitekturën e sigurisë së Aleancës, duke vënë në dukje se siguria e Europës nuk përfundon në Veriun e Largët. Sipas tij, Ballkani Perëndimor dhe veçanërisht Kosova duhet të mbeten në vëmendjen e vazhdueshme të NATO-s.

Një prej çështjeve të ngritura nga ministri Nufi ishte edhe integrimi i Kosovës në NATO, të cilin ai e cilësoi si një domosdoshmëri strategjike për forcimin e stabilitetit rajonal, parandalimin e konflikteve dhe shmangien e rrezikut të krijimit të fronteve të reja të pasigurisë në Europë.

Pjesëmarrja në **"Atlantic Future Forum 2026"** i jep Shqipërisë mundësinë të përcjellë në një forum të nivelit të lartë perspektivën e saj mbi zhvillimet e sigurisë në Europë dhe, veçanërisht, mbi rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, mesazhi i Shqipërisë mbetet i qartë: siguria euroatlantike është e pandashme dhe një NATO më e fortë në Ballkan përbën një garanci më të madhe për sigurinë e Europës.











OPERACION I PËRBASHKËT PËR PASTRIMIN E ZONAVE DETARE NGA MUNICIONET E PAPLASURA

Forca Detare dhe Komanda Mbështetëse bashkëpu-nojnë me ekipet e anijeve ushtarake të Italisë, Gjermanisë dhe Spanjës për rritjen e sigurisë detare.

Në kuadër të vizitës portuale të tri anijeve ushtarake nga Italia, Gjermania dhe Spanja, po zhvillohet një operacion i përbashkët për identifikimin dhe pastrimin e zonave detare nga municionet e paplasura.

Operacioni realizohet në koordinim me Qendrën e Zhytjes në Forcën Detare dhe Kompaninë EOD të Komandës Mbështetëse, duke bashkuar kapacitetet dhe ekspertizën e strukturave shqiptare me ato të ekuipazheve të anijeve pjesëmarrëse.

Fokusi i këtij angazhimi është evidentimi dhe neutralizimi i rreziqeve që paraqesin municionet e paplasura në hapësirën detare, me synim garantimin e sigurisë dhe krijimin e kushteve më të sigurta për aktivitetet detare në këtë zonë.

Ky bashkëpunim dëshmon rëndësinë e koordinimit ndërmjet forcave detare dhe strukturave të specializuara të vendeve partnere në përballimin e rreziqeve nënujore dhe forcimin e sigurisë detare.







STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"



PROJEKTBUXHETI 2027,
76.3 MILIARDË LEKË PËR MBROJTJEN

Modernizimi i Forcave të Armatosura, investimet strategjike dhe rritja e gatishmërisë operacionale në fokus të financimit

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, prezantoi në Komisionin për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes projektbuxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2027, në vlerën 76 miliardë e 284 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2026, financimi për mbrojtjen parashikohet të rritet me 7.5 miliardë lekë, ose rreth 10%, duke arritur në 2.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Projektbuxheti i vitit 2027 synon të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse, modernizimin e Forcave të Armatosura, rritjen e gatishmërisë operacionale dhe përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadër të NATO-s.

Gjatë prezantimit, ministri Nufi theksoi se buxheti është konceptuar në funksion të objektivave afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të mbrojtjes, duke lidhur burimet financiare me kapacitetet që synohet të ndërtohen dhe nevojat konkrete operacionale të Forcave të Armatosura.

Mbi 57% e buxhetit për investime dhe modernizim

Një nga elementet kryesore të projektbuxhetit është orientimi drejt investimeve kapitale. Nga fondi i përgjithshëm prej 76.284 miliardë lekësh, 42.8%, ose rreth 32.6 miliardë lekë, janë parashikuar për shpenzime korrente, ndërsa 57.2%, ose rreth 43.6 miliardë lekë, për shpenzime kapitale dhe investime.

Për modernizimin e Forcave të Armatosura janë planifikuar rreth 23.1 miliardë lekë. Në këtë drejtim, parashikohet blerja e armatimit të lehtë dhe dronëve, avionëve krahëfiks, zhvillimi i sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës ajrore, ndërtimi i sistemit kundër dronëve (Counter-UAS), si dhe investime në sistemin e mbrojtjes ajrore.

Gjithashtu, do të vijojë modernizimi i mjeteve të transportit dhe sistemeve të komunikimit e informacionit në Bazën Ajrore të NATO-s në Kuçovë, me synim forcimin e kapaciteteve mbështetëse dhe rritjen e ndërveprueshmërisë me aleatët.

5.9 miliardë lekë për infrastrukturën ushtarake

Një tjetër drejtim prioritar i financimit është infrastruktura ushtarake, për të cilën janë parashikuar rreth 5.9 miliardë lekë. Investimet përfshijnë ndërtimin e infrastrukturës mbështetëse për Korridorin VIII, hangarët e Shkollës së Aviacionit, rikonstruksionin e Spitalit Ushtarak dhe ndërtimin e strukturës akomoduese në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në listën e projekteve përfshihen gjithashtu ndërtimi i pjesës ushtarake të portit të ri në Porto Romano dhe rivitalizimi i Bazës Detare të Pashalimanit. Këto investime synojnë përmirësimin e kushteve infrastrukturore, rritjen e kapaciteteve logjistike dhe forcimin e mbështetjes për përmbushjen e misioneve të Forcave të Armatosura.

Në të njëjtën paketë financiare janë përfshirë edhe investime për emergjencat civile dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, duke mbështetur aftësinë e strukturave për të reaguar në kohë dhe në mënyrë të koordinuar ndaj situatave të krizës.

Kapacitete të reja dhe angazhime në kuadër të NATO-s

Projektbuxheti 2027 synon vijimin e reformave dhe zhvillimin e kapaciteteve në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura. Prioritet do të jetë pajisja e Forcave Tokësore me armatim të ri, të ndërveprueshëm me sistemet e aleatëve të NATO-s, si dhe modernizimi i pajisjeve dhe sistemeve të komunikimit e informacionit.

Një objektiv tjetër është rritja e nivelit të angazhimit të Forcave të Armatosura në operacionet e NATO-s, si dhe pjesëmarrja në misionet dhe iniciativat e reja të Aleancës. Paralelisht, do të vijojë zhvillimi dhe mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve për mbrojtjen kombëtare dhe kolektive, reagimin ndaj krizave dhe përballimin e emergjencave civile.

Në këtë kuadër, Forcat e Armatosura do të vijojnë të mbështesin edhe vendet e rajonit në përballimin e situatave emergjente, në kuadër të angazhimeve dhe mekanizmave të NATO-s, OKB-së dhe Bashkimit Evropian.

Personeli dhe integriteti institucional, pjesë e prioriteteve

Krahas investimeve në pajisje, sisteme dhe infrastrukturë, projektbuxheti i vitit 2027 i kushton rëndësi edhe burimeve njerëzore. Politikat për personelin ushtarak synojnë promovimin në karrierë, përmirësimin e trajtimit të ushtarakëve dhe lartësimin e figurës e integritetit të tyre.

Në të njëjtën kohë, në objektivat e Ministrisë së Mbrojtjes përfshihen rritja e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në Forcat e Armatosura.

Financimi për mbrojtjen, në rritje edhe në vitet e ardhshme

Gjatë prezantimit, ministri Nufi nënvizoi se Shqipëria vijon të përmbushë angazhimet e saj ndaj aleatëve, në përputhje me zotimet e Samitit të Hagës dhe atij të Ankarasë, duke përshtatur investimet në mbrojtje me sfidat dhe kërcënimet e sigurisë në kontinentin evropian. Sipas planifikimit buxhetor, financimi për mbrojtjen parashikohet të vijojë të rritet edhe gjatë tre viteve të ardhshme, me afërsisht 1 miliard lekë në vit.

Projektbuxheti 2027 përfaqëson një hap të rëndësishëm në mbështetjen financiare të transformimit të Forcave të Armatosura. Përmes investimeve strategjike, modernizimit të kapaciteteve, përmirësimit të infrastrukturës dhe mbështetjes së personelit, synohet garantimi i një force më të përgatitur, më të ndërveprueshme dhe më të aftë për të përmbushur misionet e saj kushtetuese dhe angazhimet euroatlantike të Shqipërisë.



ORA 11, DITA 11, MUAJI 11:
Kur armët heshtin, kujtesa flet

Dita e Përkujtimit Britaniko-Francezo-Gjermane në Tiranë, homazh për të rënët e Luftës së Dytë Botërore dhe mesazh për paqen, pajtimin dhe solidaritetin



Ora 11. Dita 11. Muaji i 11-të.

Një orë, një datë dhe një muaj që, përtej çdo kalendari, mbajnë brenda një prej mesazheve më të fuqishme të historisë moderne: kur armët heshtin, njerëzimi duhet të kujtojë pse ato u ngritën dhe pse nuk duhet të ngrihen më.

Në këtë simbolikë u zhvillua edhe ceremonia përkujtimore në Varrezat e Luftës të Komonuelthit dhe në Varrezat e Ushtarëve Gjermanë, pranë Parkut të Liqenit Artificial në Tiranë. Një ceremoni solemne, ku nderimi për të rënët u ndërthur me reflektimin mbi çmimin e luftës dhe vlerën e paqes.

Në këtë ditë përkujtimi, **ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi**, vendosi kurora me lule në nderim të atyre që luftuan dhe dhanë jetën për lirinë, si dhe të gjithë viktimave të Luftës së Dytë Botërore.

Ceremonia nuk ishte vetëm një akt protokollar. Në heshtjen e varrezave, mes emrave të skalitur në gur dhe kujtesës së një lufte që përfshiu miliona njerëz, ajo mori kuptimin e një mesazhi të qartë për të tashmen: paqja nuk është një trashëgimi e garantuar, por një përgjegjësi që çdo brez duhet ta mbrojë.

Një minutë heshtje për miliona jetë

Dita e Përkujtimit është një moment i veçantë për të ndalur ritmin e përditshmërisë dhe për t'u kthyer te historia. Te ata që nuk u kthyen më në shtëpi. Te familjet që mbetën pas. Te qytetet e shkatërruara. Te brezat që u rritën me pasojat e një konflikti që ndryshoi botën.

Në Tiranë, kjo kujtesë mori një dimension të veçantë, pasi në të njëjtën hapësirë prehen ushtarë të Komonuelthit dhe ushtarë gjermanë, njerëz që i përkisnin palëve të kundërta të një prej konflikteve më të mëdha të njerëzimit.

Sot, përballë këtyre varreve, nuk qëndrojnë më palët e një lufte.

Qëndron kujtesa. Qëndron njeriu. Qëndron nevoja për të mos harruar.

Dhe pikërisht këtu qëndron edhe fuqia e pajtimit: armiku i djeshëm mund të jetë pjesë e kujtesës së përbashkët të së nesërmes.



Një homazh që kapërcen kufijtë e historisë

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, e cilësoi ceremoninë një moment solemn nderimi dhe reflektimi për ata që luftuan dhe dhanë jetën për lirinë, si dhe për të gjithë ata që humbën jetën gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në mesazhin e tij, ministri vuri në qendër jo vetëm sakrificën, por edhe atë që historia i ka mësuar njerëzimit pas tragjedive të luftës: fuqinë e pajtimit, paqes dhe solidaritetit.

"Një homazh ndaj sakrificës njerëzore dhe një dëshmi e fuqisë së pajtimit, paqes dhe solidaritetit", ishte mesazhi i ministrit Nufi, duke theksuar se këto janë vlera që kapërcejnë ndasitë e së shkuarës, bashkojnë kombet dhe forcojnë miqësitë e partneritetet.

Është pikërisht kjo arsyeja pse përkujtimi nuk i përket vetëm së shkuarës.

Ai i përket së tashmes. Dhe, mbi të gjitha, së ardhmes. Sepse një shoqëri që kujton viktimat e luftës nuk kujton vetëm atë që ka ndodhur. Ajo i kujton vetes se sa e shtrenjtë është paqja dhe sa e rrezikshme është harresa.

Nga ndarja te pajtimi

Historia e Europës është e mbushur me kufij që dikur ndanin ushtri, popuj dhe ideologji. Por historia europiane është edhe historia e një transformimi të jashtëzakonshëm: nga kontinenti i luftërave te kontinenti i bashkëpunimit.

Në këtë kuptim, ceremonia në Tiranë merr një simbolikë të veçantë.

Pranë njëri-tjetrit qëndrojnë varre që dëshmojnë një epokë kur Europa ishte e ndarë nga lufta dhe sot kujtohen në një kohë kur vendet europiane janë të lidhura nga partneritete, institucione dhe angazhime të përbashkëta për sigurinë dhe paqen.

Kjo është një nga fitoret më të mëdha të kujtesës historike. Jo fshirja e së shkuarës, por shndërrimi i saj në mësim. Jo harrimi i viktimave, por nderimi i tyre, duke mos lejuar që tragjeditë të përsëriten.

Shqipëria dhe kujtesa e përbashkët europiane

Edhe Shqipëria e ka përjetuar Luftën e Dytë Botërore dhe pasojat e saj. Në territorin shqiptar u zhvilluan luftime, u humbën jetë njerëzish dhe mbetën gjurmë të thella në kujtesën kombëtare.

Prania e këtyre varrezave në Tiranë është pjesë e kësaj kujtese më të gjerë europiane.

Varrezat e Komonuelthit janë një dëshmi e ushtarëve të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Memoriali britanik në Tiranë u ngrit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Ambasadën Britanike dhe u inaugurua më 8 maj 1994, në 50-vjetorin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Sot, ky vend nuk është thjesht një hapësirë varrimi. Është një vend kujtese.

Një vend ku historia nuk shpjegohet vetëm me libra, por edhe me heshtjen e gurëve.



Kurora me lule, një gjuhë universale

Vendosja e kurorave me lule është një gjest i thjeshtë në pamje të parë, por me një kuptim të thellë. Është mënyra e njerëzimit për t'u përkulur përpara atyre që nuk mund të flasin më. ***Në ceremoninë e Tiranës, lulet u vendosën në nderim të të rënëve, duke shprehur respektin për sakrificën njerëzore dhe duke e kthyer përkujtimin në një mesazh të bashkëjetesës dhe pajtimit.***

Në një botë ku konfliktet, tensionet dhe kërcënimet ndaj sigurisë vazhdojnë të jenë pjesë e realitetit ndërkombëtar, ky mesazh mbetet veçanërisht i rëndësishëm. Sepse paqja nuk ndërtohet vetëm në tryezat diplomatike. Ajo ndërtohet edhe përmes kujtesës. Përmes respektit. Përmes aftësisë për të parë përtej ndarjeve të së shkuarës.

Ora 11, simboli i një premtimi

Ora 11 e ditës së 11-të të muajit të 11-të është kthyer në një simbol të fuqishëm të përkujtimit të atyre që humbën jetën në luftë. Në atë çast, heshtja bëhet më e fortë se çdo fjalim. Nuk ka nevojë për shumë fjalë. Mjafton të mendosh për miliona jetë të humbura. Për familjet që pritën më kot. Për ushtarët që u nisën për në front dhe nuk u kthyen. Për fëmijët që u rritën pa prindër. Për nënat që mbetën me një fotografi në duar. Për qytetet që u rindërtuan mbi rrënoja. Dhe për botën që, pas asaj tragjedie, kuptoi se bashkëpunimi është më i fuqishëm se urrejtja dhe se paqja është më e çmuar se çdo fitore e arritur me armë.

Kujtesa si përgjegjësi

Ceremonitë përkujtimore nuk kanë vlerë vetëm për ata që kanë jetuar luftën.

Ato kanë vlerë sidomos për brezat që nuk e kanë përjetuar atë.

Sepse brezi i ri duhet të dijë se liria nuk është një fjalë abstrakte. Ajo është një vlerë e paguar me jetë njerëzish.

Duhet të dijë se paqja nuk është thjesht mungesa e luftës. Është një proces i vazhdueshëm që kërkon dialog, respekt, bashkëpunim dhe gatishmëri për të parandaluar konfliktin.

Dhe duhet të kuptojë se historia nuk duhet përdorur për të ushqyer urrejtjen, por për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt.

Në këtë kuptim, homazhi i ministrit të Mbrojtjes, Ermal Nufi, në varrezat e Komonuelthit dhe të ushtarëve gjermanë, ishte një akt kujtese, por edhe një deklarim i qartë i vlerave që qëndrojnë në themel të bashkëpunimit mes kombeve: respekti për jetën, paqja, solidariteti dhe pajtimi,

Nga varrezat te e ardhmja

Në fund të ceremonisë mbetet një pamje që nuk ka nevojë për shumë shpjegime: lule mbi varre dhe heshtje përpara historisë. Por kjo heshtje nuk është bosh. Ajo flet. Flet për sakrificën. Flet për dhimbjen. Flet për lirinë. Flet për detyrimin e brezave të sotëm që të mos lejojnë rikthimin e tragjedive që Europa dhe bota përjetuan në shekullin e kaluar.



Në Tiranë, në një ditë përkujtimi të përbashkët britaniko-francezo-gjerman, mesazhi ishte i qartë: **kombet mund të kenë pasur histori të ndara, por kujtesa e viktimave i bashkon.**

Dhe pikërisht aty ku dikur flisnin armët, sot flet kujtesa. Aty ku dikur ndanin frontet, sot bashkon respekti. Aty ku dikur kishte luftë, sot qëndron një mesazh paqeje.

Ora 11, dita 11, muaji 11. Armët heshtën. Kujtesa foli. Dhe mesazhi mbetet: paqja është përgjegjësia jonë e përbashkët.

DIPLOMACIA DHE SIGURIA RAJONALE, NË AUDITORIN E KOLEGJIT TË MBROJTJES DHE SIGURISË

Ambasadori Petrit Malaj: Stabiliteti i Kosovës, një faktor kyç për sigurinë e Ballkanit Perëndimor

Në një mjedis ndërkombëtar ku zhvillimet gjeopolitike, konfliktet dhe kërcënimet e reja po riformësojnë konceptin e sigurisë, dialogu ndërmjet diplomacisë dhe institucioneve të formimit ushtarak merr një rëndësi të veçantë. Pikërisht në këtë këndvështrim, stafi akademik dhe kursantët e ***Kursit të Lartë të Oficerit (KLO)*** *dhe* ***Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP),*** *në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, patën mundësinë të ndiqnin një ligjëratë nga* ***Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Sh. T. z. Petrit Malaj.***

Auditori i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë u bë kësaj here hapësirë e një bashkëbisedimi mbi një prej çështjeve më të rëndësishme të sigurisë në rajonin tonë: stabilitetin e Kosovës dhe ndikimin e tij në sigurinë e Ballkanit Perëndimor. **Tema e ligjëratës, "Stabiliteti i Kosovës dhe siguria e Ballkanit Perëndimor në një mjedis të ri gjeostrategjik"**, e vendosi diskutimin përtej kufijve të një analize të zakonshme akademike, duke e lidhur drejtpërdrejt me sfidat që përballin institucionet e sigurisë dhe përgjegjësitë e drejtuesve të ardhshëm ushtarakë.

Ambasadori Petrit Malaj solli në këtë takim këndvështrimin dhe përvojën e tij diplomatike, duke u ndalur te zhvillimet e fundit në rajon, dinamikat e reja gjeopolitike dhe sfidat që ndikojnë në arkitekturën e sigurisë së Ballkanit Perëndimor. Në qendër të reflektimeve ishte Kosova, stabiliteti i së cilës përbën një element të rëndësishëm për paqen dhe sigurinë jo vetëm në hapësirën shqiptare, por në të gjithë rajonin.

Siguria rajonale në një realitet që ndryshon

Bota e sotme po përjeton transformime të thella të mjedisit të sigurisë. Lufta në Ukrainë, tensionet dhe konfliktet në Lindjen e Mesme, rivalitetet ndërmjet fuqive të mëdha dhe shtimi i kërcënimeve hibride kanë ndryshuar mënyrën se si shtetet vlerësojnë rreziqet dhe përgatiten për krizat. Këto zhvillime nuk mbeten larg Ballkanit Perëndimor. Përkundrazi, ndikojnë drejtpërdrejt në mjedisin e tij strategjik dhe në nevojën për koordinim, vigjilencë dhe bashkëpunim ndërmjet vendeve të rajonit.

Në këtë kontekst, diplomacia dhe institucionet e mbrojtjes kanë role të ndryshme, por plotësuese. Dialogu politik, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe komunikimi diplomatik krijojnë hapësira për mirëkuptim dhe parandalim të tensioneve, ndërsa institucionet ushtarake garantojnë përgatitjen, kapacitetet dhe gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë.

Gjatë ligjëratës, Malaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe të një qasjeje të koordinuar ndaj zhvillimeve që mund të ndikojnë në paqen dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kuadër, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, komunikimi institucional dhe angazhimi i përbashkët në strukturat euroatlantike përbëjnë elemente të rëndësishme të një vizioni të përbashkët për sigurinë.

Nga analiza strategjike te përgjegjësia e lidershipit

Një nga dimensionet më të rëndësishme të këtij takimi ishte lidhja e drejtpërdrejtë e temës me formimin profesional të kursantëve. Oficerët që ndjekin KLO-në dhe KKSHP-në ndodhen në një fazë të rëndësishme të karrierës së tyre ushtarake. Përgjegjësitë që do të marrin në vijim do të kërkojnë prej tyre jo vetëm njohuri profesionale, por edhe aftësi për të analizuar mjedisin strategjik, për të vlerësuar rreziqet, për të planifikuar operacionet dhe për të marrë vendime në situata komplekse.



Pikërisht për këtë arsye, njohja e zhvillimeve politike, diplomatike dhe gjeopolitike është pjesë e domosdoshme e formimit të një oficeri që synon të marrë përgjegjësi më të larta komanduese dhe drejtuese.



Siguria nuk është më një koncept që mund të trajtohet vetëm përmes kapaciteteve tradicionale ushtarake. Ajo kërkon kuptimin e ndërveprimit ndërmjet faktorëve politikë, diplomatikë, ekonomikë, teknologjikë dhe ushtarakë. Një vendimmarrje e përgjegjshme kërkon njohjen e këtyre ndërlidhjeve dhe aftësinë për të kuptuar pasojat që një zhvillim rajonal apo ndërkombëtar mund të ketë mbi sigurinë kombëtare.

Në këtë kuptim, ligjërata e ambasadorit Malaj ishte një mundësi për t'i parë çështjet e sigurisë nga një këndvështrim tjetër profesional, duke plotësuar njohuritë e fituara në auditor me përvojën e diplomacisë në terrenin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

NATO dhe përgjegjësitë e reja euroatlantike

Një pjesë e rëndësishme e materialit të paraqitur iu kushtua edhe ndryshimeve në mjedisin e sigurisë euroatlantike dhe rolit të NATO-s në përballimin e sfidave të reja. Për Shqipërinë, si vend anëtar i Aleancës, mbrojtja kolektive, solidariteti ndërmjet aleatëve dhe zhvillimi i kapaciteteve mbrojtëse përbëjnë shtylla themelore të sigurisë.

Zhvillimet e viteve të fundit kanë dëshmuar se besueshmëria e Aleancës mbështetet jo vetëm në angazhimet politike, por edhe në kapacitetet reale, gatishmërinë operacionale, inovacionin dhe ndarjen e përgjegjësive ndërmjet vendeve anëtare.

Në këtë kontekst u trajtua edhe drejtimi i ri i investimeve në mbrojtje, i përcaktuar në Samitin e NATO-s në Hagë në vitin 2025, si dhe nevoja për forcimin e industrisë së mbrojtjes, përshpejtimin e inovacionit dhe rritjen e bashkëpunimit transatlantik. Këto zhvillime tregojnë se siguria kërkon përgatitje afatgjatë dhe përshtatje të vazhdueshme me natyrën e kërcënimeve.

Për oficerët që përgatiten për funksione më të larta komanduese, këto çështje kanë rëndësi të drejtpërdrejtë. Ata duhet të jenë në gjendje të kuptojnë jo vetëm misionin e forcave të armatosura, por edhe kontekstin strategjik në të cilin ai realizohet.

Diplomacia dhe formimi ushtarak, dy dimensione të së njëjtës siguri

Në përmbyllje të ligjëratës, ambasadori Petrit Malaj vlerësoi ftesën, mikpritjen dhe interesimin e treguar nga drejtuesit, stafi akademik dhe kursantët e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Ai nënvizoi rëndësinë e dialogut ndërmjet diplomacisë dhe institucioneve të edukimit e formimit ushtarak, si një mundësi për të kuptuar më mirë sfidat e kohës dhe përgjegjësitë e përbashkëta.

Ky bashkëbisedim dëshmoi se formimi i një drejtuesi ushtarak nuk përfundon me përvetësimin e doktrinave, procedurave dhe njohurive operacionale. Ai kërkon horizont të gjerë strategjik, njohje të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe aftësi për të kuptuar ndikimin e diplomacisë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Për Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, takime të tilla janë pjesë e rëndësishme e pasurimit të procesit akademik, pasi krijojnë ura komunikimi ndërmjet përvojës institucionale, dijes akademike dhe praktikës profesionale.

Në fund, mesazhi që mbetet nga kjo ligjëratë është se stabiliteti i Kosovës dhe siguria e Ballkanit Perëndimor nuk janë çështje të izoluara të një shteti apo të një institucioni. Ato janë pjesë e një përgjegjësie të përbashkët, që kërkon diplomaci aktive, institucione të qëndrueshme, bashkëpunim rajonal dhe forca të armatosura të përgatitura. Sepse siguria e së ardhmes ndërtohet jo vetëm me kapacitete për t'iu përgjigjur krizave, por edhe me njohuri, dialog dhe aftësi për t'i parandaluar ato.



"MBUROJA ILIRE-26", VLERËSIM I KAPACITETEVE TË OPERACIONEVE SPECIALE

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, ndjek nga afër stërvitjen vetëvlerësuese të Regjimentit të Operacioneve Speciale



Me pjesëmarrjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, përfundoi me sukses stërvitja vetëvlerësuese **"Mburoja Ilire-26"**, e zhvilluar nga Task Grupi i Operacioneve Speciale Tokësore (SOLTG) i Regjimentit të Operacioneve Speciale.

Gjatë kësaj stërvitjeje u vlerësuan kapacitetet operacionale të njësisë, niveli i gatishmërisë së efektivave, koordinimi dhe bashkëveprimi ndërmjet strukturave pjesëmarrëse, si dhe aftësia për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

Vëmendje e veçantë iu kushtua verifikimit të aftësive për planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve, zbatimit të procedurave standarde dhe ndërveprueshmërisë, në përputhje me standardet dhe kërkesat operacionale të NATO-s.

Stërvitja "**Mburoja Ilire-26"** shërbeu si një mundësi për të vlerësuar nivelin e përgatitjes dhe performancën e efektivave, si dhe për të evidentuar pikat e forta dhe aspektet që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Pjesëmarrja e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në këtë aktivitet dëshmon rëndësinë që i kushtohet vlerësimit të gatishmërisë dhe zhvillimit të kapaciteteve të specializuara të Forcave të Armatosura.

Përmes aktiviteteve të tilla stërvitore, Regjimenti i Operacioneve Speciale vijon të forcojë profesionalizmin, gatishmërinë dhe aftësitë operacionale të personelit, në funksion të përmbushjes së misioneve kombëtare dhe angazhimeve në kuadër të Aleancës së NATO-s.





FORCAT SPECIALE SHQIPTARE NË STËRVITJEN RAJONALE "BALKAN SHIELD-26"

Forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e ndërveprueshmërisë me forcat speciale të vendeve të Ballkanit

Efektivë të Forcave Speciale të Forcave të Armatosura të Shqipërisë morën pjesë në stërvitjen rajonale **"Balkan Shield-26",** e zhvilluar në Greqi, së bashku me homologët e tyre nga shtatë vende të Ballkanit, në kuadër të iniciativës BCHOD.



Stërvitja kishte në fokus zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive operacionale në disa fusha të rëndësishme, si operacionet në zona të banuara, operacionet ajrore, përdorimi i sistemeve moderne pa pilot, si dhe teknikat e zjarrit luftarak. Përmes trajnimeve të përbashkëta dhe shkëmbimit të përvojave, pjesëmarrësit patën mundësi të zhvillonin më tej aftësitë profesionale dhe të njiheshin me praktikat e homologëve të tyre.



Pjesëmarrja e efektivëve shqiptarë në këtë aktivitet rajonal kontribuon në forcimin e bashkëpunimit ushtarak, rritjen e ndërveprueshmërisë dhe konsolidimin e marrëdhënieve mes forcave speciale të vendeve të Ballkanit, duke ndihmuar në përgatitjen e tyre për përballimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë.



BATALIONI I XHENIOS PËRFUNDON NDËRTIMIN E URËS SË RE "BAILEY"

Batalioni i Xhenios ka përfunduar ndërtimin e një ure të re metalike të tipit "Bailey", me gjatësi 24 metra dhe kapacitet mbajtës deri në 10 tonë.



Vënia në funksion e urës rikthen lidhjen infrastrukturore dhe lehtëson qarkullimin, duke përmirësuar aksesin e banorëve të fshatrave Karinë, Drungaj, Sinametaj, Triballie, Thartor, Garunjë e Vogël dhe Vrap drejt shërbimeve bazë.

Një tjetër kontribut konkret i Komandës Mbështetëse pranë Ministrisë së Mbrojtjes në mbështetje të komunitetit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.



DISIPLINA:
FORCA QË E BËN USHTRINË
NJË TRUP TË VETËM



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një tekst i vjetër, një mesazh që nuk 'plaket'

Disa shkrime mbeten të lidhura ngushtë me kohën kur janë shkruar, ndërsa të tjerë e kapërcejnë atë dhe vazhdojnë të komunikojnë me të tashmen. Vlera e tyre qëndron pikërisht në aftësinë për të ruajtur aktualitetin edhe pas shumë vitesh, sepse prekin parime dhe vlera themelore të jetës njerëzore e profesionale. Përkushtimi, përgjegjësia, profesionalizmi, disiplina dhe ndjenja e detyrës nuk varen nga koha; ato mbeten vlera të qëndrueshme, që u flasin njëlloj brezave dhe e bëjnë një tekst të vjetër të mbetet i rëndësishëm edhe sot.

Një prej tyre është edhe ky tekst i vjetër kushtuar **disiplinës**.

Sot, kur e rilexojmë, na tërheq fillimisht gjuha e një kohe tjetër. Por, përtej saj, mbetet një ide e qartë: **asnjë veprim i madh njerëzor nuk mund të ndërtohet pa disiplinë**.

Në jetën ushtarake kjo e vërtetë merr një peshë të veçantë. Disiplina nuk është thjesht respektim i rregullores, zbatim i urdhrit apo frikë nga ndëshkimi. Ajo është një nga shtyllat mbi të cilat ndërtohen gatishmëria, profesionalizmi dhe besimi.

Prandaj, ky dokument i vjetër meriton të rilexohet sot, jo si një kujtim i së kaluarës, por si një mesazh për ushtrinë e së tashmes dhe të së ardhmes.

DISIPLINA FILLON ATJE KU MBARON KONTROLLI

Në çdo veprimtari njerëzore ekziston nevoja për disiplinë. Studimi, puna, sporti, profesioni dhe çdo përpjekje që synon një rezultat kërkojnë përkushtim, rregull dhe këmbëngulje.

Por në ushtri, përgjegjësia e individit nuk përfundon te vetja.

Një ushtarak është pjesë e një strukture, ku veprimi i tij mund të ndikojë drejtpërdrejt te të tjerët. Një pakujdesi mund të rrezikojë një detyrë. Një moszbatim procedure mund të cenojë një mision. Një vendim i gabuar mund të ketë pasoja për një grup të tërë.

Prandaj, disiplina ushtarake nuk mund të jetë vetëm bindje formale. Ajo duhet të jetë ndërgjegje profesionale.

Ushtaraku duhet ta kryejë detyrën jo vetëm sepse kontrollohet, por sepse e di se ajo duhet kryer. Duhet ta respektojë rregullin jo vetëm nga frika e pasojës, por sepse kupton arsyen dhe përgjegjësinë që qëndron pas tij.

Këtu qëndron dallimi mes disiplinës së imponuar dhe disiplinës së përvetësuar.

E para mund të prodhojë bindje.

E dyta prodhon besueshmëri.

Dhe një forcë e armatosur ka nevojë mbi të gjitha për njerëz të besueshëm.

NGA URDHRI TEK PËRGJEGJËSIA

Urdhri është pjesë e natyrshme e organizimit ushtarak. Por fuqia e një force nuk matet vetëm me aftësinë për të dhënë dhe zbatuar urdhra. Ajo matet edhe me aftësinë për ta kuptuar detyrën, për ta zbatuar atë me saktësi dhe për të marrë përgjegjësi për veprimet.

Një ushtri moderne nuk mund të mbështetet vetëm te bindja mekanike. Ajo ka nevojë për njerëz që mendojnë, vlerësojnë situatën, respektojnë procedurat dhe veprojnë me përgjegjësi brenda misionit.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme sot, kur mjedisi i sigurisë është bërë më kompleks dhe kur teknologjia, informacioni, lufta kibernetike dhe kërcënimet hibride kërkojnë jo vetëm aftësi teknike, por edhe maturi e vetëkontroll.

Në një situatë të vështirë, nuk mjafton të dish çfarë duhet bërë.

Duhet të jesh i aftë ta bësh saktë, në kohë dhe nën presion.

Këtë aftësi e ndërton disiplina.

DISIPLINA ËSHTË SOLIDARITET NË VEPRIM

Në dokumentin e vjetër gjejmë një ide që edhe sot tingëllon jashtëzakonisht moderne: disiplinat e ndryshme njerëzore kanë një bazë të përbashkët – solidaritetin në veprim për një qëllim të përbashkët.

Ky është një nga përkufizimet më të fuqishme të disiplinës ushtarake.

Ushtria nuk është një grumbull individësh. Është një trup i organizuar.

Çdo ushtarak ka detyrën e tij, por detyra e tij lidhet me detyrën e tjetrit. Çdo njësi ka përgjegjësinë e vet, por suksesi i saj lidhet me suksesin e strukturave të tjera.

Në një mision, askush nuk është vetëm. Prandaj, fjala "ne" duhet të ketë më shumë peshë se fjala "unë".

Disiplina i mëson individit të kontrollojë egon, të respektojë shokun, të pranojë përgjegjësinë dhe të vendosë misionin mbi interesin personal. Kjo nuk e zvogëlon individin. Përkundrazi, e bën kontributin e tij më të vlefshëm. Një ushtarak i aftë është vlerë për veten dhe për karrierën e tij. Por një ushtarak i aftë, i disiplinuar dhe i besueshëm është vlerë për të gjithë strukturën.



DISIPLINA

— *Shka âsht përgjithsisht disiplina.*
— *Disiplina Ushtarake.*
— *Si mësohet disiplina.*
— *Mjete disiplinore.*
— *Nevoja e disiplinës.*

1. — SHKA ÂSHT PËRGJITHSISHT DISIPLINA.

Po të marrim në shqyrtim çdo veprim aktiviteti njerzuer shofim se ky nuk mund të zhvillohet pa atë gjâ që na zakonisht e thrasim *disiplinë* dhe se kjo disiplinë âsht e domosdoshëme që nji i tillë aktivitet të mund të marri qindresë për me i arritë qëllimit për të cillin proponohet.

Eksistojnë kështu disiplina të panjehuna sikurse janë të panjehuna nevojat e njerzve të cilat për me i çue në vënd kërkojnë nji bashkëveprim edhe nji shumsí punimit.

Por të gjitha këto forma disipline kanë nji bazë të vetme: «solidaritet në veprim për qëllimin e përbashkët» me sundue çdo ndiesí ose ambicjon personal para qëllimit që duhet t'i arrihet.

DISIPLINA DHE SHEMBULLI

Disiplina nuk ndërtohet vetëm me rregullore. Ajo ndërtohet me shembull.

Drejtuesi që respekton kohën, zbaton standardin, mban përgjegjësi dhe sillet me drejtësi, vendos një standard që ndiqet edhe nga të tjerët. Nuk mund të kërkohet disiplinë aty ku mungon shembulli. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në formimin e brezit të ri të ushtarakëve. Rregullorja tregon se çfarë duhet bërë, por shembulli tregon se si duhet jetuar detyra.



— 4 —

Shum herë çuditemi, të hutuem me konsiderue hapsin e *botës* edhe arrijmë në përfundimin që në botë gjith çka âsht harmoní e se vetëm për këtë harmoní âsht e mundëshëme të zhvillue-mit e jetës; shofim edhe se çdo gjâ rregullohet me ligjë, çdo gjâ i përulet ligjëve të caktueme mirë që rregullojnë edhe vênë për fijë ç'do aktivitet e lëvizje.

Shoqnija nuk mund t'i shmanget këtij parimi rregulluës që gjejmë në natyrë, dhe në ç'do mënyrë që kjo shoqëní çfaqet edhe nën çë do paralel për eksistencën e sajë, ka nevojë për disiplinë: përmbi të gjitha disiplina dhe rregullimi i çfaqjeve shpirtnore të panumërta. Në këtë mënyrë janë rregullue, vendue dhe disiplinue përpjekjet e të drejtës ndërmjet qytetarëve me qytetarë dhe ndërmjet qytetarëve me Shtet: në këtë mënyrë janë disiplinue nzitjet, karakteret me të çfaqunat e tyne, prirjet dhe instinktet. E qé pra se në shoqní rendin e parë e xanë *të drejtat dhe detyrat* me të gjitha përshkrimet dhe përfundimet ndëshkuese që rrjedhin zakonisht.

Kurse flasim për disiplinë nuk duhet të kuptojmë *robní*, por lypset të ndalohemi përkundra tek mejtimi i *detyrës* «detyrë e nji burri të lirë».

Një institucion i fortë nuk ndërtohet vetëm nga rregulla të mira. Ndërtohet nga njerëz që i kthejnë ato rregulla në kulturë pune. Kur korrektësia bëhet zakon, përgjegjësia bëhet karakter dhe profesionalizmi bëhet mënyrë sjelljeje, atëherë kemi arritur nivelin më të lartë të disiplinës.

DISIPLINA NË USHTRINË E SOTME

Sot flasim për një ushtri më moderne, më teknologjike dhe më të integruar me strukturat euroatlantike. Përdorim sisteme të avancuara, mjete të reja komunikimi, kapacitete kibernetike, mjete ajrore pa pilot dhe teknologji që vetëm pak dekada më parë dukeshin të largëta.

Por sa më e sofistikuar bëhet teknologjia, aq më e madhe bëhet përgjegjësia e njeriut që e përdor atë.

Teknologjia nuk e zëvendëson disiplinën.

Përkundrazi, kërkon më shumë disiplinë.

Një sistem i avancuar nuk ka vlerë nëse nuk përdoret sipas procedurës. Një informacion i saktë nuk ka vlerë nëse nuk trajtohet me përgjegjësi. Një kapacitet i fuqishëm nuk ka vlerë nëse mungon njeriu i përgatitur për ta vënë atë në funksion të misionit.

Prandaj, pavarësisht ndryshimit të kohës, një parim mbetet i pandryshuar: Mjetet mund të ndryshojnë. Njeriu mbetet faktori vendimtar.

Dhe te njeriu fillon disiplina.

ÇFARË NA MËSON SOT NJË TEKST I VJETËR?

Ndoshta kjo është arsyeja më e fortë për të sjellë sot në faqet e "Ushtrisë" një dokument të tillë.

Jo për nostalgji. Jo për të rikthyer një gjuhë të vjetër. Por për të parë se disa vlera nuk kanë nevojë të modernizohen, sepse janë vetë themeli mbi të cilin ndërtohet profesionalizmi. Brezi i sotëm i ushtarakëve ka sfida të tjera. Ka një realitet të ri sigurie, teknologji të reja dhe përgjegjësi të reja. Por pyetja themelore mbetet e njëjtë: A mund të mbështetet misioni te ti në momentin kur gjithçka varet nga veprimi yt?

Përgjigjja nuk jepet në ditën e krizës.

Ajo ndërtohet çdo ditë. Në stërvitje. Në respektimin e standardit. Në korrektësinë ndaj detyrës. Në mënyrën si trajton shokun. Në mënyrën si përgatitesh për një detyrë që sot mund të duket e zakonshme, por nesër mund të jetë vendimtare. Kjo është arsyeja pse disiplina është më shumë se një kërkesë ushtarake. Ajo është një mënyrë të menduari dhe të vepruari.

Në fund të fundit, një ushtri nuk bëhet e fortë vetëm nga armët që zotëron, nga **teknologjia që përdor apo nga numri i njerëzve që ka në radhët e saj.** Ajo bëhet e fortë kur njerëzit e saj **mund t'i besojnë njëri-tjetrit**. Dhe besimi nuk ndërtohet me fjalë. Ndërtohet me disiplinë. Kur ushtari e di se shoku i tij do të jetë në vendin e duhur, në kohën e duhur dhe do të bëjë detyrën e tij; kur komandanti e di se vartësit e tij janë të përgatitur dhe të përgjegjshëm; kur çdo pjesëtar i një njësie e kupton se veprimi i tij është pjesë e një misioni më të madh se vetja – atëherë kemi një forcë të aftë për të përballuar edhe sfidat më të vështira.

Kjo është forca e vërtetë e disiplinës. Ajo nuk duket gjithmonë. Nuk bën zhurmë. Nuk kërkon duartrokitje. Por është aty, në çdo detyrë të kryer saktë, në çdo standard të respektuar, në çdo vendim të marrë me përgjegjësi dhe në çdo ushtarak që qëndron i palëkundur përballë detyrës. Prandaj, mesazhi i atij dokumenti të vjetër është ende i gjallë:

Disiplina nuk është frikë nga ndëshkimi. Është besnikëri ndaj detyrës. Nuk është bindje pa menduar. Është përgjegjësi për të vepruar drejt. Nuk është nënshtrim i individit. Është bashkimi i individëve rreth një misioni.

Dhe mbi të gjitha: **Disiplina është ajo që e kthen një grup njerëzish në një forcë, një forcë në një trup dhe një trup në një mburojë të besueshme për vendin.**

Në kohë paqeje ajo ndërton gatishmërinë. Në stërvitje ajo ndërton profesionalizmin. Në momentin e rrezikut ajo bëhet instinkt. Dhe kur vjen ora e provës, nuk pyetet më nëse një ushtri ka rregulla.

Pyetet nëse **njerëzit e saj janë të gatshëm t'i zbatojnë ato kur gjithçka është në lojë**.

Pikërisht aty provohet disiplina.

Pikërisht aty provohet profesionalizmi.

Dhe pikërisht aty provohet forca e një ushtrie.

Sepse një ushtri mund të ketë armët më moderne, por arma e parë e saj mbetet njeriu i disiplinuar.

Dhe një njeri i disiplinuar nuk është thjesht një ushtarak që zbaton një rregull.

Është njeriu që, kur vendi ka nevojë për të, di të bëjë detyrën, pa u lëkundur.

MOS E HUMBIM SHQIPEN
DUKE E FOLUR

Nga "Formula e Pagëzimit" e Pal Engjëllit te sfida e kohës sonë: një gjuhë që mbijetoi pesë shekuj nuk mund të varfërohet nga indiferenca jonë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



Datat që i përkasin historisë janë të rëndësishme, sepse janë gur themeli i ekzistencës së një kombi, edhe pse kanë ndodhur shekuj më parë, vazhdojnë të na flasin drejtpërdrejt. **8 Nëntori 1462** është një prej tyre.

Atë ditë, në një kohë të trazuar për shqiptarët dhe për Europën, **Pal Engjëlli** shkroi **"Formulën e Pagëzimit"**, dëshminë më të hershme të dokumentuar deri tani të gjuhës shqipe. Disa fjalë u hodhën në letër dhe, pa e ditur askush se çfarë udhëtimi të gjatë do të bënin, ato kaluan përtej kohës.

Kaluan nëpër shekuj. Kaluan nëpër luftëra. Kaluan nëpër pushtime, ndalime, varfëri, shpërngulje dhe mërgime. Dhe erdhën deri tek ne. Kjo është mrekullia e një gjuhe.

Një gjuhë mund të mos ketë pasur gjithmonë shtetin e saj, institucionet e saj, shkollat e saj dhe lirinë e saj, por mund të ketë pasur diçka shumë më të fortë: **njerëzit që e flisnin dhe refuzonin ta harronin.**

Prandaj, 8 Nëntori nuk është vetëm një përvjetor historik. Është një ditë që na vendos përballë një përgjegjësie.

Sepse ne e morëm shqipen nga ata që erdhën para nesh.

Dhe një ditë do t'ua dorëzojmë atyre që do të vijnë pas nesh.

Pyetja është e thjeshtë, por e rëndë: **Në çfarë gjendjeje do t'ua dorëzojmë?**

Një gjuhë që mbijetoi shekuj, nuk mund të mposhtet nga moda

Shqipja nuk është thjesht një mjet komunikimi.

Është kujtesë.
Është histori.
Është këngë.
Është lutje.
Është ninullë.
Është fjala e nënës.
Është zëri i babait.
Është gjuha e gjyshërve që na kanë treguar historitë e familjes.
Është fjala e poetit.
Është kënga e mërgimtarit.
Është mall, dashuri, dhimbje dhe krenari.

Brenda gjuhës sonë jetojnë shumë prej gjërave që na bëjnë shqiptarë. Prandaj, kur humbasim një fjalë, nuk humbasim vetëm një fjalë. Humbim një nuancë të kujtesës.

Kur një shprehje e bukur popullore del nga përdorimi, nuk zhduket vetëm një mënyrë të foluri. Zbehet një copëz e kulturës që e ka mbajtur gjallë atë shprehje për breza.

Dhe kur një fëmijë shqiptar rritet duke e kuptuar shqipen, por pa e folur, nuk humbet vetëm një aftësi gjuhësore. Humbet një urë.

Një urë me gjyshërit. Me historinë e familjes. Me letërsinë. Me këngën. Me kujtesën. Me vendin prej nga kanë ardhur të parët.

Kjo është arsyeja pse gjuha nuk duhet trajtuar si një çështje e vogël.

Nuk është.

Është çështje identiteti.

Të duash gjuhët e huaja, pa harruar gjuhën tënde

Sot jetojmë në një botë tjetër.

Fëmijët shqiptarë mësojnë anglisht që në moshë të vogël. Të rinjtë studiojnë në universitete të huaja. Shqiptarët punojnë në kompani ndërkombëtare, udhëtojnë, komunikojnë dhe jetojnë në shumë vende të botës.

Ky nuk është një kërcënim.

Është një mundësi.

Një shqiptar që di anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht apo çdo gjuhë tjetër nuk është më pak shqiptar.

Përkundrazi, është më i pasur.

Problemi nuk është të mësosh gjuhë të huaja. Problemi është të harrosh gjuhën tënde.

Problemi nuk është të përdorësh një term të huaj kur ai është i nevojshëm.

Problemi është ta përdorësh atë edhe atëherë kur shqipja ka një fjalë të qartë, të bukur dhe të saktë.

Dhe kjo po ndodh gjithnjë e më shpesh.

Në bisedat e përditshme, në reklama, në rrjete sociale, në komunikimin publik, në media, në dokumente, në gjuhën e institucioneve, një fjalë e huaj futet në një fjali ku nuk ka asnjë nevojë të jetë.

Pastaj përdoret përsëri. Dhe përsëri. Derisa fillon të na duket normale. Kështu ndryshon gjuha. Jo gjithmonë me një revolucion. Shpesh me një zakon të vogël. Me një fjalë të përdorur pa nevojë. Me një fjalë shqipe të harruar.

Me një brez që mësohet të mendojë se fjala e huaj është më moderne.

Dhe këtu duhet të jemi të kujdesshëm. Sepse moderniteti nuk matet me numrin e fjalëve të huaja që përdorim. Një njeri nuk bëhet më modern sepse thotë një fjalë në anglisht në vend të një fjale shqipe.

Një institucion nuk bëhet më profesional sepse mbush komunikimin me terma të huaj.

Një media nuk bëhet më prestigjioze sepse titulli i saj tingëllon i huaj.

Moderniteti është aftësia për të qenë pjesë e botës pa humbur veten.

Shqipja nuk ka nevojë të mbyllet në një muze

Ruajtja e gjuhës nuk do të thotë ta vendosim shqipen nën një kupolë qelqi.

Gjuhët janë të gjalla. Ato ndryshojnë. Pasurohen. Krijojnë fjalë të reja. Përshtaten me shkencën, teknologjinë dhe zhvillimin shoqëror. Shqipja duhet të jetë gjuhë e së ardhmes.

Duhet të jetë në teknologji.
Në shkencë.
Në diplomaci.
Në ushtri.
Në administratë.
Në universitete.
Në media.
Në internet.
Në rrjetet sociale.
Në komunikimin modern.

Nuk mund të kërkojmë që të rinjtë ta duan një gjuhë që ua paraqesim vetëm si një relikte të së kaluarës.

Shqipja duhet t'u tregojë brezave të rinj se është në gjendje të flasë edhe për inteligjencën artificiale, hapësirën, teknologjinë, sigurinë kibernetike, shkencën, ekonominë, kulturën dhe botën moderne.

Një gjuhë e fortë nuk është ajo që i trembet fjalës së re. Është ajo që di ta përpunojë, ta përshtatë dhe ta bëjë të vetën. Kjo është rruga. Jo izolimi. Por as dorëzimi.

Rreziku më i madh nuk vjen nga jashtë, vjen nga indiferenca

Ndoshta këtu qëndron paradoksi më i madh. Për shekuj, shqiptarët luftuan për të mos e humbur gjuhën. Sot askush nuk po na ndalon të flasim shqip.

Askush nuk po na mbyll shkollat shqipe. Askush nuk po na ndalon të botojmë libra shqip. Askush nuk po na ndalon të shkruajmë shqip. Dhe pikërisht për këtë arsye përgjegjësia jonë është edhe më e madhe.

Sepse sot rreziku nuk është ndalimi. Është indiferenca. Është mendimi se nuk ka rëndësi. Është "kështu flasin të gjithë". Është "nuk ka problem". Është "mjafton të kuptohemi".

Jo.

Nuk mjafton vetëm të kuptohemi. Duhet edhe të ruajmë mënyrën se si shprehemi. Sepse gjuha është më shumë se informacion. Gjuha është kulturë.

Dhe kultura nuk mund të mbijetojë nëse brezat nuk e marrin seriozisht.

Rrjetet sociale, vendi ku gjuha po fiton dhe po humbet njëkohësisht

Një pjesë e madhe e jetës së sotme zhvillohet në ekran. Të rinjtë shkruajnë më shumë se çdo brez tjetër. Por jo gjithmonë shkruajnë më mirë.

Mesazhe të shkurtra.

Fjalë të shkurtuara.

Gabime drejtshkrimore.

Shenja, simbole, shkurtime dhe një përzierje e vazhdueshme mes shqipes dhe anglishtes.



Në një komunikim të shpejtë, shumë prej këtyre dukurive mund të duken të padëmshme.

Por problemi fillon kur ajo gjuhë e përkohshme bëhet mënyra kryesore e të shkruarit.

Kur një i ri fillon ta ketë të vështirë të shkruajë një paragraf të plotë në shqip.

Kur fjalori i tij kufizohet.

Kur një fjalë shqipe i duket e çuditshme, ndërsa fjala e huaj i duket "normale".

Atëherë kemi arsye të shqetësohemi.

Jo sepse duhet t'u shpallim luftë rrjeteve sociale.

Përkundrazi.

Duhet t'i përdorim ato për ta bërë shqipen më të pranishme.

Të botojmë libra.

Të ndajmë poezi.

Të tregojmë histori.

Të prezantojmë fjalë të bukura shqipe.

Të krijojmë përmbajtje cilësore.

Të tregojmë se shqipja mund të jetë edhe gjuhë e teknologjisë, edhe gjuhë e humorit, edhe gjuhë e shkencës, edhe gjuhë e artit.

Nëse rrjetet sociale janë një nga hapësirat ku formohet gjuha e brezit të ri, atëherë shqipja duhet të jetë aty.

E pranishme. E gjallë. E bukur. E përdorshme.

Në familje fillon mbrojtja e gjuhës

Shkolla ka përgjegjësinë e saj. Institucionet kanë përgjegjësinë e tyre. Media ka përgjegjësinë e saj. Por gjuha ka një vend ku lind dhe forcohet përpara të gjitha këtyre: familjen. Nëse në shtëpi fëmijës i flitet shqip, ai e merr shqipen si diçka të natyrshme. Nëse i lexohen libra shqip, ai krijon marrëdhënie emocionale me gjuhën. Nëse dëgjon prindërit dhe gjyshërit të tregojnë histori, ai mëson jo vetëm fjalët, por edhe kujtesën.

Prandaj familjet shqiptare që jetojnë jashtë vendit kanë një mision të veçantë.

Fëmijës nuk i duhet zgjedhur mes gjuhës së vendit ku jeton dhe shqipes.

Mund t'i ketë të dyja.

Madje mund të ketë shumë më tepër. T'i mësosh fëmijës shqipen nuk do të thotë t'i mbyllësh një derë. Do të thotë t'i hapësh edhe një tjetër.

Sepse gjuha e nënës është një trashëgimi që nuk blihet.

Nuk zëvendësohet. Dhe kur humbet, nuk është gjithmonë e lehtë të rikthehet.

Media duhet të jetë mburojë e gjuhës

Ka një përgjegjësi të veçantë edhe për ne që shkruajmë. Gazetaria nuk është vetëm transmetim lajmi. Është edhe përdorim i gjuhës publike. Një titull gazete mund të lexohet nga mijëra njerëz. Një lajm televiziv mund të dëgjohet nga qindra-mijëra. Një tekst në internet mund të shpërndahet në pak minuta në të gjithë botën. Prandaj çdo gazetar, redaktor, shkrimtar, mësues, studiues dhe krijues përmbajtjeje ka një përgjegjësi të vogël, por të rëndësishme.

Të mos e varfërojë gjuhën.

Të mos përdorë fjalë të huaja për efekt.

Të mos e sakrifikojë shqipen për një modë kalimtare.

Të mos e trajtojë korrektësinë gjuhësore si një luks.

Sepse një tekst i shkruar mirë nuk është vetëm më i bukur. Është më i qartë.

Më i saktë. Më i besueshëm. Dhe mbi të gjitha, është një shembull.

Çfarë do t'u lëmë atyre që do të vijnë pas nesh?

Pal Engjëlli nuk mund ta dinte se fjalët që shkroi do të ruheshin për më shumë se pesë shekuj. Ai thjesht shkroi. Por pasardhësit e tij i ruajtën. Dhe ne sot i kujtojmë. Kështu funksionon trashëgimia.

Një brez merr.

Një brez ruan.

Një brez përcjell.

Dhe në këtë zinxhir nuk ka vend për neglizhencë. Sepse, nëse një hallkë dobësohet, zinxhiri këputet.

Ne kemi marrë nga të parët tanë një gjuhë që ka kaluar nëpër një histori të jashtëzakonshme. Na kanë ardhur fjalë nga goja më gojë. Nga kënga në këngë.

Nga dorëshkrimi në dorëshkrim. Nga familja në familje. Nga një brez në tjetrin.

Sot radha është e jona. Nuk na kërkohet të bëjmë heroizma.

Na kërkohet të mos e lëmë pas dore.

Të lexojmë.

Të shkruajmë.

Të flasim.

Të korrigjojmë.

Të mësojmë fëmijët.

Të përdorim fjalën shqipe kur ajo është aty.

Të pranojmë fjalën e huaj kur është vërtet e nevojshme.

Të krijojmë fjalë të reja kur koha i kërkon.

Dhe, mbi të gjitha, të mos kemi turp nga shqipja.

Nga një fjali e shkruar në 1462,
te një amanet për 2026

Pesë shekuj e gjysmë më parë, Pal Engjëlli shkroi disa fjalë. Sot ne shkruajmë mijëra fjalë çdo ditë. Por pyetja nuk është sa shumë shkruajmë.

Pyetja është çfarë po bëjmë me gjuhën që shkruajmë.

A po e pasurojmë?

A po e ruajmë?

A po e bëjmë më të aftë të shprehë kohën tonë?

A po ua mësojmë fëmijëve?

A po ua lëmë brezave të ardhshëm si një pasuri apo si një gjuhë të lodhur nga përdorimi pa kriter?

8 Nëntori duhet të na kujtojë se një gjuhë mund të mbijetojë për shekuj.

Por edhe se një gjuhë mund të dobësohet në pak breza, nëse njerëzit që e flasin pushojnë së kujdesuri për të.

Prandaj, le të mos e shohim këtë ditë vetëm si një faqe të historisë.

Ta shohim si një pasqyrë.

Në njërën anë është Pal Engjëlli, me fjalët e tij të shkruara në vitin 1462.

Në anën tjetër jemi ne.

Dhe midis nesh janë më shumë se pesë shekuj histori. Çfarë do të shkruajmë ne në këtë faqe të historisë? Ndoshta përgjigjja fillon me një gjë fare të thjeshtë:

Të flasim shqip.

Të shkruajmë shqip.

Të lexojmë shqip.

Të mendojmë shqip.

Të krijojmë në shqip.

Dhe ta duam shqipen jo vetëm kur flasim për atdheun, por edhe kur shkruajmë një mesazh, kur rrisim një fëmijë, kur japim një mësim, kur botojmë një artikull, kur shkruajmë një dokument, kur krijojmë një vepër.

Sepse atdheu nuk ruhet vetëm në kufijtë e tij. Ruhet edhe në fjalët e tij.

Dhe shqipja është një nga ato fjalë të mëdha që na bashkojnë.

Le ta ruajmë.

Jo nga bota.

Por përballë harresës.

Jo duke refuzuar të renë.

Por duke mos harruar rrënjët.

Jo duke e mbyllur shqipen në të shkuarën.

Por duke e çuar atë të gjallë drejt së ardhmes.

Sepse ata që na e lanë shqipen nuk na lanë vetëm një gjuhë për të folur. Na lanë një identitet për të mbrojtur.

Dhe ky amanet nuk ka mbaruar.

Tani është radha jonë.

PROF. DR. PROLETAR HASANI:

Historia ushtarake nuk është vetëm kujtesë e së kaluarës, por një përgjegjësi për të ardhmen

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



(...vijon nga numri i kaluar)

Si lindi ideja për të realizuar veprën madhore "Historia e Ushtrisë Shqiptare", në disa vëllime?

Dëshira dhe shtysa për të shkruar e publikuar një histori për fillesat dhe krijimin e Ushtrisë Shqiptare i ka zanafillat shumë herët, ende pa përfunduar studimet e larta ushtarake. Që aty nga fillimet e viteve tetëdhjetë të shekullit të shkuar nisa të shkruaja e të botoja nëpër organet ushtarake të asaj kohe shkrime lidhur me çështje të caktuara për aspekte të organizimit të Ushtrisë Shqiptare në periudha të ndryshme të historisë së Shqipërisë.

Por, ideja për të shkruar këtë histori u formësua dhe nisi të marrë jetë në fillimet e viteve nëntëdhjetë dhe konkretisht në vitin 1994, në kohën që u krijua Departamenti i Historisë Ushtarake të asaj, që atë vit u emërtua Akademia e Shtabit të Përgjithshëm dhe sot mban emrin Akademia e Forcave të Armatosura. Kjo ide lindi dhe u shtrua si nevojë e domosdoshme për të pasur edhe ushtria (Forcat e Armatosura) historinë e krijimit dhe ecurinë e saj në çdo periudhë të historisë së Shqipërisë. Njëkohësisht, shkrimi dhe publikimi i kësaj historie është e nevojshme për njohjen e saj nga të gjithë brezat e shqiptarëve, por edhe nga të huajt, si një pjesë përbërëse e shtetit shqiptar, që nga koha e krijimit të tij, më 28 Nëntor 1912.

Pikërisht në këtë kohë, për herë të parë hodha dhe shtrova përpara dy anëtarëve të tjerë të këtij Departamenti, nënkolonele Msc. Engjëllushe Sulaj dhe major Msc. Asllan Zemani, idenë mbi përgatitjen e një projekti studimor për Historinë e Ushtrisë Shqiptare. Ky projekt duhej të shtrihej nga viti i largët 1912 deri në fundin e viteve tetëdhjetë të Shek. XX dhe, sipas idesë sonë parashikonte që lënda e Historisë së Ushtrisë Shqiptare të trajtohej në dy vëllime që, së bashku, shtriheshin e rroknin hapësirën e viteve 1912 (4 dhjetor) deri në fundin e vitit 1990. Prandaj ne si hartues të projekt-idesë, menduam që vepra të ndahej në dy vëllime, i pari do të trajtonte historinë e kësaj ushtrie për periudhën nga 4 dhjetori 1912 me krijimin e Qeverisë së shtetit të parë të pavarur shqiptar (28 Nëntor 1912) dhe shtrihet deri në kohën e pushtimit fashist të Shqipërisë, më 7 Prillin e vitit 1939.

Në vijim të këtij projekti do të përgatitej vëllimi i Dytë, i cili kishte për subjekt trajtese historinë e ecurisë së kësaj ushtrie në periudhën e gjatë afro dyzetepesëvjeçare 1945-1990. Vëllimi dallohet për veçoritë në emërtim e përmbajtje të Ushtrisë së pas Luftës së Dytë Botërore, 1939-1945.

Për të lidhur të dy vëllimet e mësipërm menduam që të përgatitej edhe një libër i ndërmjetëm. U mendua i tillë, sepse në të duhet të pasqyrohej historia e ndërlikuar dhe fati i Ushtrisë Shqiptare (mbretërore), që nga pragu i agresionit fashist të 7 Prillit 1939, i cili çoi në pushtimin e Shqipërisë dhe vijoi deri në pragun e çlirimit të Shqipërisë, në nëntorin e vitit 1944.

Por, në harkun e viteve të pushtimit fashist, krahas ushtrisë si forcë e armatosur e qeverive që u krijuan dhe vepruan në Shqipërinë e pushtuar, u ngritën edhe forca të armatosura joqeveritare, vullnetare. Këto forca, që synonin luftën kundër pushtuesve të huaj fashistë dhe pushtetit të tyre në vend, ishin vepër e aktorëve politikë, që lindën në Shqipëri nga fundi i vitit 1941 deri në vitin 1944. Midis këtyre forcave të armatosura ishte edhe ushtria Partizane Vullnetare Shqiptare (UNÇPV).

Zbatimi i këtij projekti me rëndësi për historinë e lindjes dhe të ecurisë së Ushtrisë Shqiptare nis që në fillim të vitit pasues 1995, por vëllimi i parë e pa dritën e botimit vetëm në dhjetorin e vitit 2000, nga Shtëpia Botuese e ushtrisë (SHBU), e cila sot nuk ekziston më. Mirëpo, pas trembëdhjetë viteve, pikërisht në vitin 2023, libri u ribotua, por tashmë i pasuruar në dokumente dhe botime e studime të reja, të shumta, i pajisur me një aparat të pasur shkencor. Tanimë libri i ribotuar përfshinte një vëllim prej më se 650 faqesh dhe i ilustruar me shumë fotografi, faksimile dokumentesh, harta e pasqyra me të dhëna për Ushtrinë Shqiptare. Por ka një dallim thelbësor në botimin e ri të këtij libri, ai tani u rishkrua, përveç tre anëtarëve të parë, me pjesëmarrjen edhe të katër autorëve të tjerë. Autorët e këtij botimi të ri, përveç tre të botimit të parë, Prof. Dr. Proletar Hasani, Dr. Asllan Zemani, Msc. Engjëllushe Sula, janë ofruar edhe Msc. Sali Onuzi, Prof, Asc. Dr. Marenglen Kasmi dhe Prof. Asc. Dr. Teki Kurti. Botimi i ri i "Historisë së Ushtrisë Shqiptare", Vëll. I, 1912-1939 (Tiranë 2023), kësaj radhe u realizua nën siglën e Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake (ISHU) dhe me mbështetjen financiare të znj. Bora Zemani.

Ndërkohë kanë dalë në dritë botime me titujt "Historia e Pashkruar" (Tiranë, 1999) dhe "Në rrjedhat e luftës …" (Tiranë, 2025), të autorit P. Hasani. Këta libra, së bashku me studimin në përgatitje për ecurinë e Ushtrisë Shqiptare në harkun e viteve të pushtimit të Shqipërisë, 1939-1944, e ndonjë botim tjetër, plotësojnë historinë e saj në këto vite.

Ndërmarrja më e vështirë është ajo që ka lidhje pikërisht më atë që do të plotësonte mozaikun e Historisë së Ushtrisë Shqiptare, është punimi madhor i kësaj historie për periudhën naziste 1945-1990. Vështirësitë vijnë më së shumti për shkak të mungesës së mbështetjes financiare, të cilat kanë një raport të ndërsjellë më njëra-tjetrën.

Kjo ishte në të vërtetë zanafilla, ecuria dhe konkretizimi i idesë për të shkruar dhe publikuar "Historinë e Ushtrisë Shqiptare".

Ju keni qenë anëtar dhe drejtues në institucione dhe projekte shkencore. Si e vlerësoni rëndësinë e këtyre angazhimeve?

Po, është e vërtetë, për më se tridhjetë e dy vite të jetës dhe veprimtarisë time i jam përkushtuar studimeve dhe njëherësh edhe jetës akademike, si mësimdhënës (pedagog) e drejtues i Historisë Ushtarake dhe i Historisë së Artit Ushtarak Shqiptar.

Ama, dashuria ime për letrat e shkruara dhe për shkrimet letrare (poezi dhe përshkrime, tregime të shkurtra, reportazhe, analiza etj.) i ka fillimet qysh herët në shkollën e mesme dhe, sidomos gjatë studimeve dhe përfundimit të shkollës së oficerëve dhe emërtimit në qytetin e Shkodrës. Ky qytet, pa hezitim ka qenë si një muzë e frymëzim për t'u ngjitur në një shkallë më të lartë krijimi për mua. Në këtë kohë, një rol të ndjeshëm ka luajtur njohja me shumë krijues të shquar shkodranë të shumë zhanreve e fushave, me emër në gjithë Shqipërinë e më gjerë. Midis tyre ka qenë dramaturgu Fadil Kraja, regjisori i shquar Serafin Fanko, shkrimtari Frederik Rreshpja, karikaturisti i veçantë Shtjefën Palushi (Tefa), humoristi e shkrimtari Paulin Selimi, gjuhëtari i madh Prof. Dr. Jup Kastrati e shumë të tjerë. Ishte koha kur qyteti i Shkodrës ziente nga veprimtaritë e larmishme historike, kulturore, artistike, sportive, etj., ku nuk mund të qëndroje anash dhe pa u përfshirë.

Pikërisht në këtë kohë dhe në këtë qytet, që ka qenë dhe mbetet qendër e kahershme e tyre, e Shqipërisë, por edhe e rajonit tonë, unë përfitova një pjesë të mirë të formimit, të frymëzimit dhe të afrimit tim në fushën e krijimtarisë.

Por, në të vërtetë karriera ime si studiues dhe mësimdhënës, posaçërisht në atë të Historisë Ushtarake nisi dhe u konsolidua pas përfundimit të studimeve të larta ushtarake dhe të masterit e kualifikimeve në Historinë Ushtarake.

Pikërisht në këtë periudhë të re, u bëra pjesë e institucioneve akademike studimore-shkencore dhe të atyre mësimdhënëse ushtarake gjithmonë në fushën e Historisë Ushtarake dhe të Historisë së Artit Ushtarak shqiptar, por natyrisht edhe më gjerë. Në vitet '70 e, sidomos, në ato '80 të shekullit të shkuar programet dhe projektet në fushën akademike (mësimdhënie), por veçanërisht studimi, kërkimi dhe studimet ushtarake, patën një hov dhe zhvillim të dukshëm. U ngritën dhe zhvillonin veprimtarinë e tyre disa institucione kërkimore e shkencore në fushën ushtarake, vijonin të botoheshin një numër organesh të shtypit ushtarak, si dhe të perfeksionoheshin institucionet ushtarake të mësimdhënies, si shkolla dhe akademi ushtarake. Të gjitha këto zhvillime kërkonin edhe kërkues, studiues, pedagogë e drejtues të aftë profesionalisht.

Njëherazi me to, morën jetë dhe u realizuan një sërë projektesh, në të cilat u angazhuan një numër i madh studiuesish dhe pedagogësh. Këta u bënë të njohur jo vetëm në qarqet akademike ushtarake, por edhe më gjerë, duke fituar tituj e grada shkencore e akademike dhe duke u afirmuar përmes punimeve dhe botimeve të tyre. Një prej tyre kam qenë edhe unë.

Çfarë vendi zë Historia e Luftës Antifashiste NÇ në studimet tuaja dhe pse zënë një vend qendror?

Historia e Luftës Antifashiste NÇ e popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë për çlirimin e Shqipërisë dhe rikthimin e pavarësisë e sovranitetit të humbur prej pushtimit, natyrisht që zë një vend të rëndësishëm e qendror në studimet e mia. Afrimiteti im si studiues e pedagog me këtë temë e ka zanafillën me temën time të doktoraturës, e cila e merr subjektin pikërisht nga Lufta Antifashiste NÇ, sigurisht e trajtuar brenda kufijve të Historisë Ushtarake, përderisa ajo emërtohet "Organizimi ushtarak i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, 1939-1944". Doktorata u mbrojt në Akademinë Ushtarake (sot Akademia e Forcave të Armatosura), institucioni më i lartë i arsimit ushtarak, institucion ky që kishte të drejtën e mbrojtjes së gradave shkencore në fushën e mbrojtjes, që prej marsit të vitit 1973. Më pas, në vitet 1994, këtij institucioni iu njoh e drejta, që si pjesë e arsimit të lartë shqiptar, krahas mbrojtjes së doktoraturave, të organizonte programet Master (në dy nivele: shkencor e profesional), si dhe propozimi për tituj Profesor dhe Prof. Asc.

Në këtë rrjedhë, së bashku me kërkimet arkivore e nëpër bibliotekat për botime shkencore, në shtypin e shkruar, si dhe vjeljes së kujtimeve të veteranëve, drejtuesve dhe pjesëmarrësve në LANÇ, për të përgatitur e mbrojtur doktoraturën, unë u përfshiva dhe u lidha ngushtësisht me këtë periudhë të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar! Kësisoj ajo u bë pjesë e burim i shumicës së studimeve dhe botimeve të mia që prej fillimeve të viteve '80 të shekullit të shkuar deri më sot.

Sigurisht ajo nuk është e vetmja temë apo projekt në veprimtarinë time studimore-shkencore, njëherësh edhe në aspektin akademik ushtarak.

Natyrisht, në këtë histori, punimet e historianëve ushtarakë përqendrohen më së shumti në studimin dhe trajtimin e çështjeve ushtarake, të përshfaqur në veprimet luftarake të kryera në suazën e kësaj lufte të popullit shqiptar. Ndër to bëjnë pjesë çështje të organizimit ushtarak të forcave të armatosura pjesëmarrëse në këtë luftë, për furnizimin me armatime e municione, ushqime, veshje e medikamente mjekësore; mbi përpunimin e taktikës së tyre të luftimit kundër pushtuesve e deri tek stërvitja, disiplina, morali dhe mënyrat e gjykimit të partizanëve dhe sjelljen e tyre ndaj robërve. Pjesë e pandarë e studimeve tona ushtarake për historinë e periudhës së LANÇSH është edhe organizimi i organeve të drejtimit ushtarak, si shtabet e komandat e formacioneve luftarake, planet e botimeve dhe bashkëveprimi midis këtyre forcave gjatë veprimeve luftarake deri tek bashkimi me misionet ushtarake aleate në Shqipëri gjatë kësaj lufte etj.

Prandaj, për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj, në thelb, dhe sidomos në krahasim me krejt krijimtarinë time shkencore, padyshim historia e LANÇ-it e Ushtrisë NÇ dhe historisë ushtarake në tërësi, zë vend qendror dhe pjesën më të madhe të saj. Kurorëzimi i këtij investimi në studimet e mia janë disa botime, që mund të quhen me interes, besoj se janë Organizimi ushtarak i forcave të Ushtrisë NÇ gjatë viteve të LANÇ-it, 1939-1944. Doktoratë, [mbrojtur në Akademinë Ushtarake (sot e Forcave të Armatosura), Tiranë, 1989]; "Historia e artit ushtarak të popullit shqiptar gjatë Luftës Antifashiste NÇ, 1939-1944" (Botim i Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, Tiranë, 1987, bashkautor); "Historia e Pashkruar" (Tiranë, 1999, autor); "Në rrjedhat e luftës…" (Tiranë 2024, autor). Nuk po ndalem në këtë rast te Fjalori Enciklopedik Shqiptar (në tre vëllime), si autor

i afro 20 zërave, gjithashtu me temë nga Historia Ushtarake, dhe në dhjetëra studime e artikuj shkencorë, që i përkasin po kësaj fushe.

Por me Historinë Ushtarake, me atë të Artit Ushtarak gjatë Luftës Antifashiste NÇ të popullit shqiptar janë marrë përpara e së bashku me mua edhe studiues të njohur ushtarakë, si Skënder Isaku, Dilaver Radeshi, Elami Sado, Kadri Cenolli, Prof. Dr. Shahin Leka, Doktorët e Shkencave Myzafer Bonaj, Virgjil Janku, Petrit Manaj, Avni Hajro, Asllan Zemani, Msc. Engjellushe Sulaj, Msc Sali Onuzi, Përparim Rexhepi etj. Krahas me mua kanë lëvruar edhe studiues edhe pedagogë më të rinj, si Prof. Asc. Dr. Bernard Zotaj, Prof. Asc. Dr. Marenglen Kasmi, e të tjerë.

Si i krahasoni brezat e vjetër dhe të rinj në raport me ndjenjën e atdhedashurisë dhe disiplinën akademike/ushtarake?

Kjo është një pyetje interesante dhe njëherësh po aq e vështirë që t'i japësh përgjigje, për disa arsye, sepse vetë krahasimi apo përqasja mes brezave të vjetër me ata të rinj është po aq e vështirë.

Krahasimi i këtyre treguesve themelorë në raportin e mësipërm, mes brezave të vjetër me ata të sotëm, në këndvështrimin tim është dukshëm jo i njëjtë në çdo fushë të jetës.

Në këtë përqasje, së pari duhet mbajtur parasysh se kanë ndryshuar dukshëm kohët, në të cilat kanë lindur, janë rritur, edukuar e formuar dhe kanë vepruar brezat e vjetër krahasuar me ata të sotëm. Për rrjedhojë kanë ndryshuar thellësisht nga njëra periudhë tek tjetra, vetë sistemet politike apo regjimet, parimet, konceptet e rregullat lidhur me edukimin e formimin si dhe të jetës, të punës e të mbrojtjes së vendit. Këto ndryshime, natyrisht, kanë ndikuar edhe në ndryshimin e motiveve e të kritereve të menduarit, të jetës e të sjelljes së brezave të vjetër deri në fundin e viteve '90 të Shek. XX në raport me ata të brezave të rinj të pas viteve 2000, si dhe në lidhje me ndjenjën e atdhedashurisë e të disiplinës akademike/ushtarake.

Për brezat e vjetër atdhedashuria dhe disiplina kanë qenë më përcaktuese e të paprekshëm e "tabu", sepse askush nuk mund t'i diskutonte e aq më pak t'i atakonte ato. Kjo, sepse ndjenja e dashurisë për Atdheun ishte, mes të tjerave, kyçi ose hallka e bashkimit dhe e unitetit të popullit e të brezave.

Atdhedashuria atëherë nënkuptonte mos largimin nga vendi, mos largimin nga puna, të shkoje e të jetoje atje ku kishte nevojë Atdheu dhe mbrojtja e tij nga çdo armik, pra çdo gjë lidhej me Atdheun dhe dashurinë ndaj tij. Këto të gjitha shiheshin si detyrë e detyrim për çdo shqiptar. Ndërsa pas vitit 1990 shumë nga këta tregues kanë ndryshuar. Ndërsa disiplina ishte pjesë e përditshmërisë dhe e ndërgjegjes. Kurse, sot për brezat e rinj këto parime apo tregues nuk duket të kenë të njëjtën ngarkesë dhe nuk përbëjnë më "tabu".

Në kohën e brezave të vjetër sistemi shtetëror ishte njëpartiak (monist), vendi ishte mbyllur ndaj botës, nuk lejohej lëvizja e lirë, jeta e punës bazohej në parime e rregulla strikte, kurse shërbimi ushtarak ishte i detyrueshëm për çdo shtetas.

Ndërsa, pas vitit 1991, sistemi i vjetër shtetëror ra dhe u zëvendësua me një sistem shumëpartiak-demokratik, u lejua fjala e mendimi i lirë, vendi u hap ndaj botës dhe u mundësua lëvizja e lirë, shërbimi i detyrueshëm u hoq dhe Shqipëria u demilitarizua. Për rrjedhojë edhe këndvështrimi për çështje të tilla të rëndësishme e primare, si dashuria për Atdheun e nacionalizmi dhe, sidomos, mbi disiplinën ushtarake-akademike, natyrisht kanë ndryshuar dukshëm tashmë.

Në përmbyllje mund të them se, sipas mendimit tim, qëndrimi i brezave të rinj në krahasim me brezin e vjetër, në raport me dashurinë për Atdheun e disiplinën akademike/ushtarake është i ndryshëm e me diferenca. Ky dallim, padyshim, ka arsyet dhe shpjegimet e veta.

Çfarë ndikimi mendoni se ka pasur "Fjalori Enciklopedik Shqiptar" në ndërtimin e kujtesës kolektive shqiptare?

Unë mendoj se çdo libër, edhe shkencor qoftë ai, tregon interes dhe ndikon me vlerat që përcjell në kujtesën dhe formimin e lexuesve.

Kurse, Fjalori Enciklopedik Shqiptar përfaqëson një vepër me karakter shkencor, të shkruar me një stil sintetik dhe përgjithësues. Në zërat apo artikujt e tij të shkurtër e të ngjeshur, në pak radhë e pa shumë hollësi, pasqyrohet krejt bota shqiptare më tërësinë e saj, që nga historia e kombit dhe e trojeve etnike e diasporës, nga lashtësia deri në ditët tona.

Përmes kësaj vepre me rëndësi e përmbajtje të pasur atdhetare, u jepet të gjithë shqiptarëve, por jo vetëm atyre, një pamje gjithëpërfshirëse mbi historinë, gjeografinë, ekonominë, arsimin e kulturën, si dhe letërsinë e gjuhën shqipe, artet, shtypin e botimet, mjetet e komunikimit, fizkulturën e sportet, fenë etj. Po ashtu jepen të dhëna për çështjet dhe arritjet politiko-shoqërore si dhe dhjetëra zëra me të dhëna mbi personalitetet kryesore shqiptare, por edhe të huaj që kanë lidhje me Shqipërinë, në fusha të ndryshme të jetës së saj. Kësisoj, një vepër e tillë, siç është edhe Fjalori Enciklopedik Shqiptar, i cili mund të lexohet nga çdo shqiptar, me të dhënat që përcjell nga të gjitha fushat e jetës së vendit që nga kohërat më të vjetra deri në ditët e sotme, ngjall pa dyshim një ndjenjë të natyrshme krenarie tek çdo shqiptar.

Arritjet që sheh dhe lexon në këtë libër të bëjnë, padyshim, të ndihesh krenar dhe i lidhur me to. Ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kujtesës sonë kolektive, duke na ndihmuar të mos i harrojmë, t'i ruajmë e t'i përcjellim brez pas brezi, por edhe të nxjerrim mësime dhe përvojë prej tyre, për të ecur me besim drejt së ardhmes.

Si përfundim mund të them se kjo vepër, por edhe shumë të tjera krahas saj, kanë ndikuar e ndikojnë në ndërtimin e kujtesës kolektive tek bashkatdhetarët tanë, aq më tepër në kushtet që gjendet dhe që po kalon Shqipëria sot.

Besoj se këtë ndikim do të ketë ky botim madhor edhe për brezat e sotëm e të ardhshëm, lidhur me kujtesën kolektive e cila të çon, gjithsesi, tek dashuria për Shqipërinë dhe popullin shqiptar.

Si e shihni të ardhmen e studimeve të Historisë Ushtarake në Shqipëri dhe çfarë do të rekomandoni për përparimin e kësaj fushe?

Që në fillim mund të them me keqardhje se këto studime i shoh me skepticizëm, për shkak se janë mënjanuar e lënë në harresë. Sipas mendimit dhe vlerësimeve të mia, kjo ndodh sepse, të paktën që prej pesëmbëdhjetë viteve, institucionet e studimit të Historisë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë shuar dhe nuk ekzistojnë më. Gjithashtu edhe studiuesit e formuar në vitet e shkuara për këtë fushë, nuk janë më.

Institucionet e këtij lloji të ngritura hap pas hapi me shumë investime e të trashëguara të paktën që nga fillimet e viteve '60 të shekullit të shkuar, që erdhën në rritje e kualifikime të domosdoshme deri në fillimin e viteve nëntëdhjetë po të atij shekulli, nisën të tkurreshin e të shkurtoheshin derisa u shuan aty nga vitet dymijë. Të tilla qenë Katedra (1961-1993), Dega e Studimit të kësaj fushe e Qendrës së Studimeve Ushtarake (1980-1984), Departamenti i Historisë Ushtarake, që pasoi Katedrën e mëparshme, departament ky që, ndonëse modest në numrin e paktë të pedagogëve dhe studiuesve të tij, u përmblodh në një seksion me vetëm 2-3 anëtarë. Këta ishin mësimdhënës (pedagogë), të cilët mbulonin procesin akademik.

Për rrjedhojë, bashkë me këto organizma mësimdhënëse (akademike) e studimore-shkencore, erdhën në rrallim, deri në largimin e plotë edhe të studiuesit e kërkuesit të kualifikuar të Historisë Ushtarake. Ata ishin një plejadë syresh, që nga më të hershmit, ata që vunë gurët e parë të institucioneve të kësaj fushe, si Dilaver Radëshi, Skënder Isaku, Kadri Cenolli, Ibrahim Pajova, Mustafa Novi, Kiço Janko, Malo Hashova, Qebir Zeneli, Filip Tushi, Bejto Isufi, Hasan Subashi, Dr. Myzafer Bonaj, Prof. Dr. Shahin Leka, Dr. Avni Hajro, Dr. Virgjil Janku, Dr. Petrit Manaj, Dr. Veli Haxhiu, Msc. Engjëllushe Sula, Msc. Bashkim Qeli e ndonjë tjetër.

Për të krijuar një numër të tillë studiuesish e pedagogësh, të cilët tashmë nuk janë më, janë dashur shumë vite, punë e investime për t'u përgatitur, duke çuar në një numër të madh studimesh dhe leksione për auditorët dhe shkollat e Akademinë Ushtarake (sot e Forcave të Armatosura) të Shqipërisë.

Prej shumë vitesh këto struktura e studiues nuk ekzistojnë prandaj edhe produkti për Historinë Ushtarake ka shteruar në nivel institucional, duke ndikuar në këtë dukuri edhe mungesa e investimeve e projekteve konkrete dhe bashkëpunimit me institucione apo studiues jashtë strukturave të Mbrojtjes në këtë fushë me rëndësi në formimin e ushtarakut dhe edukimin e popullsisë sonë.

Në këto rrethana ajo që rekomandoj është të hidhen sytë nga organizimet në këtë fushë në strukturat e institucioneve të arsimimit dhe kualifikimit të Forcave të Armatosura të vendeve të NATO-s, pjesë e të cilave jemi edhe ne dhe t'u referohemi atyre.

Së dyti, është e domosdoshme të krijohen lidhjet me institucionet që sot merren me trajtimin pikërisht të këtyre temave, siç është Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake, etj., ky është hapi i parë, i shpejtë dhe më i mundshëm për t'u bërë. Ky institut përbëhet nga studiues të kualifikuar, shumica me grada e tituj shkencorë, si Dr. Shk. e Prof. Dr., të cilët janë të specializuar dhe profilizuar për trajtimin e studimeve me tematikë nga Historia Ushtarake. Ky institut ka në përbërje një numër të vlerësueshëm studiuesish dhe pedagogë të njohur, të cilët nuk janë më pjesë e ndonjë institucioni akademik ekzistues në përbërje të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Këta studiues të lirë merren me projektet e ideuar e të miratuara nga Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake, që bazohen në investimet personale modeste.

Ky është një ndër propozimet konkrete për institucionet akademike të Mbrojtjes, të cilat e kanë në misionin dhe programet e tyre edhe studimin e publikimin e veprave me karakter historiko-ushtarak. Por, është e habitshme që këto institucione anashkalojnë afrimin dhe bashkëpunimin me ish-pedagogët dhe studiuesit që kanë qenë pjesë e institucionit të tyre. Madje as punimet e tyre e të Institucionit të mësipërm, të vetëm sot në Shqipëri, nuk pranojnë edhe kur ua dhurojmë e jo më të blejnë disa kopje të librave të tillë si "Historia e Ushtrisë Shqiptare, 1912-1939", botim i vitit 2023, etj., për bibliotekat e institucionit.

Për të mos u ndalur tek heshtja ndaj kërkesave për bashkëpunim dhe mbështetje të projekteve tona me tema nga Historia Ushtarake Shqiptare, të cilat realisht janë pjesë e historisë dhe e programeve të tyre.

Gjithashtu sugjeroj ringjalljen e studimeve të kësaj fushe me rëndësi për edukimin e ushtarakëve shqiptarë, por edhe të brezit të ri. Kjo, sipas këndvështrimit tim, mundësohet ose duke ngritur një strukturë të posaçme studimore-shkencore, ose duke mbështetur dhe bashkëpunuar me ISHU-në, me studiuesit e tij përmes problemeve të përbashkëta. Ringritja e një strukture të re do të kërkonte përzgjedhjen, përgatitjen dhe kualifikimin e studiuesve të rinj, të cilët do të ringjallnin e do të rikthenin studimet për Historinë Ushtarake. Ajo përfshin një përvojë të gjatë e të pasur dhe përbën një bazë të domosdoshme për akademitë ushtarake shqiptare në edukimin dhe formimin e ushtarakëve, sepse historia në përgjithësi dhe ajo ushtarake në veçanti është një histori për të njohur të shkuarën dhe për t'u përgatitur për mbrojtjen e sotme dhe të ardhshme të vendit!

Çfarë roli luajnë gjuhët e huaja në kërkimin shkencor dhe në bashkëveprimin ndërkombëtar për një studiues shqiptar?

Në punën kërkimore-shkencore, ku përfshihen edhe ato kushtuar Historisë Ushtarake, si në çdo fushë tjetër studimi, njohja dhe përdorimi i gjuhëve të huaja është me rëndësi, për të mos thënë i domosdoshëm.

Kjo ndodh për disa arsye, mes të cilave dy janë më kryesoret. Së pari vjen nga nevoja për komunikim me studiues të huaj ndërkombëtarë në lidhje me projekte apo tema të përbashkëta ose jo. Komunikimi është si një çelës për të hapur e zhvilluar biseda, diskutime profesionale përreth çështjeve apo temave të caktuara, të cilat kanë lidhje ose janë pjesë e projekteve të përbashkëta ndërkombëtare.

Kurse së dyti, njohja e gjuhëve të huaja i vjen në ndihmë studiuesve, edhe të fushës sonë, për të ndjekur gjurmët e dokumenteve të veçanta e të rëndësishme që gjenden nëpër arkivat apo bibliotekat e Shqipërisë edhe në gjuhë të huaja dhe, sidomos në arkivat e vendeve të tjera. Pikërisht, njohja dhe analiza e këtyre dokumenteve origjinale, të shkruara në gjuhën e një vendi të huaj, kërkon me patjetër njohjen e asaj gjuhe. Kjo sepse, leximi i dokumenteve të nxjerra nga burime arkivore të huaja, ndikon që studiuesi të njihet drejtpërdrejt me përmbajtje të të dhënave, të cilat kanë lidhje me ngjarje, personazhe apo çështje të rëndësishme të studimeve apo publikimeve të caktuara. Njëkohësisht citimet apo referimet e marra nga një dokument origjinal, në gjuhën e hartuesit përmban vlera shkencore të pakundërshtueshme, janë më reale dhe bindëse për lexuesin apo studiuesit e tjerë, se sa kur ato merren nga çdo lloj përkthimi e çdo lloj konteksti.

Pyetjes se sa gjuhë të huaja duhet, ose është e mira, të njohë studiuesi, vështirë se mund t'i përgjigjesh me saktësi. Por, një gjë kuptohet lehtë, sa më shumë gjuhë të huaja njeh e përdor një studiues, aq më shumë burime të ardhura nga burime të ndryshme mund të përdorë ai. Dhe, ajo që vlen më së shumti në këtë qasje është besnikëria e studimeve e botimeve përkatëse.

Ky është sipas pikëpamjes dhe përvojës time të gjatë, roli që ka dhe luan te çdo studiues, i çdo fushe qoftë ai, njohja dhe përdorimi i gjuhëve të huaja si në kërkimet dhe studimet shkencore dhe në bashkëpunimet në plan ndërkombëtar.

Çfarë mesazhi do t'u jepni të rinjve që duan të ndjekin një rrugë të ngjashme me tuajën, në shërbim të atdheut dhe dijes ...?

Mesazhi im është krejt i thjeshtë për këdo që synon të ndjekë rrugën në shërbim të Atdheut e të dijes, modestisht do të ishte si më poshtë.

Sipas pikëpamjes dhe përvojës time, gjëja e parë, pika më e fortë dhe bazë për të tjerat është dashuria e respekti për vendin e popullin tënd. Pa këta tregues nuk mund t'i shërbesh atyre, popullit dhe Atdheut!

Këtë e them sepse në ditët e sotme dhe për brezat e sotëm, atë të ashtuquajturin "Gjenerata Z", kanë ndryshuar shumëçka në përqasje me periudhën deri në vitet 2000. Ndryshimet janë rrjedhojë logjike dhe e natyrshme, si e ndërtimit të sistemeve politike të para e pas viteve '90 të shekullit të shkuar, hapja e vendit dhe lëvizja e lirë e njerëzve në hapësirat ndërkombëtare, vendosja e statusit të fjalës, e mendimit dhe e zgjedhjes së lirë të vendit ku çdo kush mund të studiojë e jetojë, ashtu si dhe kushtet më të mira të jetesës, sigurisë së kujdesit për shëndetin, pagat më të larta, si dhe të pranisë së faktorëve të shumtë social. Së bashku me zhvillimin e paparë të teknologjisë, ato kanë ndikuar e kushtëzuar edhe koncepte e parime të tilla tabu, si atdhedashuria, përkushtimi ndaj vendlindjes, uniteti, ndjenja e nacionalizmit etj., që ishin të pacenueshme për shqiptarët deri aty nga fillimi i viteve '90 të shek. XX. Kësisoj edhe shërbimi ndaj atdheut shihej ndryshe nga brezat e rinj e të sotëm, gjë që ndikon edhe në tregues të tjerë me atdheun, dashuria dhe shërbimi ndaj tij e për të. Në përfundim duket sikur koncepti i dashurisë për atdheun, për ndjenjën e shërbimit të përkushtuar e të detyruar ndaj vendit, e kanë bërë të duket atë si jo të detyrueshëm e disi jo të "modës", apo si diçka e "dalë kohe" e që më tepër tashmë i përket traditës, së shkuarës!

Gjithkush e di mirë dhe e ndjen se për t'i shërbyer vendit tënd, duhet ta duash atë me zemër, duhet të duash gjithçka që ka lidhje me të, të bësh gjithçka të duhur për të zhvilluar, përparuar atë. Por, për ta bërë atë të tillë, të zhvilluar e të përparuar, midis vendeve të zhvilluara e me demokraci perëndimore, kërkohet të përvetësohen dijet e kohës në çdo fushë të jetës, duke përdorur me efektivitet, parimet dhe teknologjitë më të mira të kohës, për të shfrytëzuar pasuritë e panumërta të vendit tonë dhe për të rritur mirëqenien e popullit shqiptar, si dhe për të përforcuar sigurinë dhe mbrojtjen e Shqipërisë. Dhe mundësitë për të ndjekur rrugët për marrjen e dijeve për brezat e rinj, në kohën e sotme, janë të pafundme. Janë qindra shkolla të niveleve të ndryshme, dhjetëra e qindra shkolla profesionale dhe universitete e akademi brenda e jashtë Shqipërisë, civile por edhe ushtarake. E, rrugët e format për t'i ndjekur studimet në to dhe për të marrë dije në to e përmes tyre, janë po aq të shumta.

Prandaj, mesazhi im miqësor dhe i sinqertë për të gjithë ata bashkatdhetarë të brezave të rinj, të cilët dëshirojnë të ndjekin rrugën e bukur, por të vështirë njëherësh tejet të vështirë, ajo që duhet dhe ajo që pritet, më së shumti, është që prej këtyre zhvillimeve, dukurive e diferencave që kanë ndodhur në kohën e tyre dhe në Shqipërinë tonë, në rrugën e gjatë të periudhës së demokracisë është ky: Nëse dëshironi dhe jeni vërtet të bindur të ndiqni rrugën e brezit tim të përkushtuar, të lindur e të rritur në kohë tjetër, në rrethana e kushte krejt të ndryshme, me një tjetër frymë e përkushtim ndaj vendit tonë të përbashkët, për të cilat i grish e i ftoj me zemër, u sugjeroj që nëse vendosin ta përshkruajnë këtë rrugë, që patjetër ta duan më së pari vendin-atdheun e tyre dhe, të vënë gjithë dijet e tyre në shërbim të atdheut tonë të përbashkët!

ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

LILIANA KONOMI MERO: NJË JETË MES UNIFORMËS, DIJES DHE KUJTESËS

Nga vajza që në vitin 1967 hyri në kursin e parë të oficereve, te gruaja që edhe sot vijon të japë kontributin e saj në jetën shoqërore dhe në ruajtjen e kujtesës ushtarake



Në jetë ndodh të marrim vendime që merren në pak minuta, por përcaktojnë një jetë të tërë. Ashtu sikurse ka momente që, edhe pse duken të zakonshme kur i përjeton, vite më vonë kupton se kanë qenë kthesa të rëndësishme jo vetëm për jetën tënde, por edhe për historinë e një brezi.

Për **Liliana Konomi Meron**, një prej atyre momenteve ishte vera e vitit 1967. Ishte maturante në Tiranë. Si shumë të rinj të asaj kohe, ajo po përjetonte ditët e fundit të gjimnazit dhe po mendonte për të ardhmen. Por një takim i veçantë do t'i ndryshonte drejtimin jetës.

Ishte korrik i vitit 1967, kur maturante të disa gjimnazeve të Tiranës ishin mbledhur në një takim me Katina Starjen, atëherë sekretare e Partisë së rajonit nr. 3 të qytetit. Ajo u foli për kujtimet e saj nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, si partizane e Brigadës II Sulmuese. Në fund të bisedës, Katina Starja u dha vajzave një lajm që për kohën ishte i pazakontë: **në shtator do të niste kursi i parë i vajzave për oficere.**

Ndoshta në atë çast shumë prej tyre nuk e kuptuan plotësisht se çfarë nënkuptonte kjo. Por Liliana e kuptoi mjaftueshëm për të marrë një vendim.

Ajo doli vullnetare

E para kishte dalë **Liliana Gjermeni**, e dyta, **Liliana Konomi**.

Të dyja ishin "Qemalstafse", të dyja ishin edhe fqinje, banonin në të njëjtin kat të pallatit në rrugën "Kongresi i Përmetit", në Tiranë.

Një njohje e lagjes do të shndërrohej në një udhëtim të përbashkët drejt një profesioni që, për vajzat shqiptare të asaj kohe, ishte ende një terren i panjohur.

Një udhëtim drejt së panjohurës

Në gushtin e vitit 1967, Liliana dhe një grup maturantësh të gjimnazeve të Tiranës morën pjesë në aksionin për ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe, në sektorin e Tamarës, pranë kufirit me Malin e Zi.

Ishin ditët e fundit të aksionit. Por, ndërsa të tjerët do të vazhdonin punën, disa vajza dhe djem u njoftuan se duhej të ktheheshin më shpejt në Tiranë.

Mes tyre ishte Liliana. Bashkë me të ishin Zhaneta Nasi dhe Ermira Bozo, të cilat më vonë do të bëheshin ndërlidhëse.

Udhëtimi drejt Tiranës nuk ishte ai udhëtim i gëzueshëm që mund të pritej nga një grup të rinjsh që sapo kishin mbyllur një aksion veror, ata po shkonin drejt së panjohurës.

Në karrocerinë e hapur të një kamioni, rreth njëzet të rinj po udhëtonin drejt Shkollës së Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha", dinin vetëm kaq.

Nuk dinin shumë për atë që i priste. Nuk e dinin saktësisht se si do të ishte jeta e tyre. Nuk e dinin se sa e vështirë do të ishte stërvitja. Nuk e dinin se si do ta përballonin disiplinën ushtarake.

Dhe ndoshta pikërisht kjo e bënte udhëtimin edhe më të veçantë. Në kthesat e Leqeve të Hotit, kamioni i hidhte sa në një anë në tjetrën. Por përtej lodhjes së udhëtimit, në mendjen e Lilianës dhe shoqeve të saj kishte një pyetje të madhe:

Çfarë na pret? Përgjigjja do të vinte vetëm pasi të kalonin portat e Shkollës.

Kur një vajzë hyri për herë të parë në rrugën e oficerit

Shtatori i vitit 1967 nuk ishte thjesht fillimi i një viti të ri shkollor. Për Liliana Konomin dhe vajzat e tjera ishte fillimi i një kapitulli të ri. Ishte kursi i parë i vajzave për përgatitjen si oficere, ato nuk po hynin thjesht në një shkollë.

Po hynin në një botë të ndërtuar mbi disiplinën, rregullin, përgjegjësinë, stërvitjen dhe hierarkinë ushtarake, por mbi të gjitha po hynin në një botë ku duhej të provonin veten.

Në fillim kishte ndrojtje, kishte kërshëri, kishte pyetje, kishte edhe pasiguri. Por, kishte një gjë që nuk mungonte: vendosmëria.

Një prej njerëzve të parë që Liliana takoi në Shkollë ishte Tefta Ngresi, nga Berati. Një njohje e çastit, por që do të shndërrohej në një miqësi të fortë. Të dyja u caktuan fillimisht në togën e ndërlidhjes. Përzgjedhja nuk ishte rastësore. Në atë togë ishin përfshirë vajza me rezultate të larta në shkollën e mesme.

Por Liliana dhe Tefta kërkuan të ndryshonin. Ato zgjodhën këmbësorinë. Dhe kjo zgjedhje thotë shumë për karakterin e tyre, ndoshta i tërhoqi terreni, ndoshta dëshira për të qenë më shumë jashtë klasës, ndoshta sfida. Apo ndoshta thjesht ndjenin se aty ishte vendi i tyre. Këmbësoria u ofronte më shumë stërvitje në terren, më shumë taktikë, zjarr, fizkulturë dhe përballje të drejtpërdrejtë me vështirësitë. Për dy vajza të reja, ishte një zgjedhje që kërkonte karakter.

Dhe Liliana nuk është penduar kurrë për të.

27 vajza që u bënë një trupë

Në togën e këmbësorisë ishin 27 vajza. Ato ishin të ndryshme në karakter, në prejardhje, në mënyrën e të menduarit dhe në përvojat që sillnin nga familjet e tyre. Por Shkolla do t'u mësonte diçka tjetër. Do t'u mësonte të ishin bashkë, të stërviteshin bashkë, të përballonin lodhjen bashkë, të ndihmonin njëra-tjetrën; të respektonin rregulloren, të respektonin eprorët, të ishin të sakta në detyrë.

Dhe mbi të gjitha, të kuptonin se në një formacion ushtarak askush nuk mund të ecë vetëm. **Kjo ishte ajo që sot do ta quanim kohezion.**

Atëherë, ndoshta nuk e përdornin këtë term në mënyrë të vetëdijshme, por e jetonin.

E kanë përshkruar edhe vetë vajzat e atij brezi, në kujtimet e tyre: ato e pranuan njëra-tjetrën me ndryshimet që kishin dhe u lidhën përmes vështirësive. Ky është një nga mësimet më të bukura që vjen nga kujtimet e Liliana Konomit.

Uniforma mund të jetë e njëjtë, por njerëzit brenda saj janë të ndryshëm. Ajo që i bashkon është detyra.

Tefta, Lushi dhe kujtimet që nuk fshihen

Në rrëfimin e Lilianës, njerëzit nuk shfaqen thjesht si emra. Ata kanë zë. Kanë fytyrë. Kanë një kujtim. Kanë një vend në atë periudhë të jetës. Tefta Ngresi është ndër figurat



më të dashura të kujtimeve të saj. Ato flinin pranë njëra-tjetrës në krevatet marinarë.

Liliana lart, Tefta poshtë. Në pushime këndonin. Tefta kishte një zë të bukur. Liliana e shoqëronte me zë të dytë. Pastaj bashkoheshin edhe vajzat e tjera. Dhe kënga e togës përhapej përtej mureve të Shkollës. Banorët e pallateve përreth i dëgjonin.

Vite më vonë, Arta Dama, banore e lagjes dhe më pas edhe vetë oficere, do t'u tregonte se i kishte dëgjuar ato vajza duke kënduar këngë patriotike dhe partizane. Është një detaj i vogël. Por pikërisht këto detaje e bëjnë një histori të madhe. Sepse historia nuk është vetëm data.

Është edhe zëri.
Është kënga.
Është miqësia.
Është një krevat marinari.
Është një shoqe që fle poshtë.
Është një rresht në fund të kolonës.
Është një shaka në pushim.
Është lodhja pas stërvitjes.
Është emocionimi para provimit.

Është një këngë që ngrihet nga një grup vajzash dhe dëgjohet në lagje.

Këto janë gjërat që nuk i gjen gjithmonë në dokumentet zyrtare.

Por pa to, historia do të ishte e paplotë.

Nga terreni te auditorët, nga toga te pedagogu

Dy vitet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve ishin vetëm fillimi. Pas përfundimit të shkollimit, Liliana Konomi do të ndërtonte një karrierë të gjatë dhe të larmishme në Forcat e Armatosura. Ajo do të shërbente në detyra të ndryshme. Do të ishte pedagoge e lëndës së taktikës. Do të ishte komandante toge në batalionin xhenier të Urave të Lehta. Do të punonte në bibliotekën e Akademisë, gjatë stazhit të Universitetit. Do të ishte shefe e degës së botimeve në Ministrinë e Mbrojtjes. Do të jepte mësim edhe në fushën e filozofisë marksiste-leniniste në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha". Më pas do të punonte për tre vjet si asistente pedagoge në Shkollën e Lartë të Partisë "Vladimir Iliç Lenin". Një rrugëtim i tillë tregon se uniforma për Lilianën nuk ishte vetëm një veshje. Ishte profesion. Ishte përgjegjësi. Ishte dije. Ishte përgatitje. Ishte edhe një mundësi për të transmetuar te të tjerët atë që kishte mësuar.

Kjo është një nga veçoritë e karrierës së saj: ajo nuk mbeti vetëm në rolin e atij që merr dijen, por u bë edhe pjesë e atyre që e përcjellin atë.

Një profesion që kërkonte shumë më tepër se disiplinë

Të jesh oficere nuk do të thotë vetëm të dish rregulloren. Do të thotë të dish të marrësh përgjegjësi. Të drejtosh njerëz. Të marrësh vendime. Të organizosh. Të mësosh. Të stërvitësh. Të ruash qetësinë në vështirësi. Dhe, mbi të gjitha, të kuptosh se pas çdo detyre ushtarake janë njerëzit. Pikërisht për këtë arsye përvoja e Lilianës si pedagoge dhe komandante merr një rëndësi të veçantë.

Ajo ka qenë në të dyja anët e procesit, ka qenë kursante, ka qenë oficere, ka qenë komandante, ka qenë pedagoge, ka qenë pjesë e strukturave të botimeve.

Dhe kjo e ka bërë të mundur që ta shohë jetën ushtarake nga këndvështrime të ndryshme.

Ndoshta kjo është edhe arsyeja pse sot kujtimet e saj kanë një vlerë të veçantë.

Ato nuk janë kujtime të një dite.

Janë kujtime të një epoke.

"Pesha dhe bukuria e uniformës", kujtesa e një brezi

Uniforma ka bukurinë e saj. Por ka edhe peshën e saj. Pesha nuk është vetëm fizike. Është pesha e përgjegjësisë. Pesha e disiplinës. Pesha e detyrës. Pesha e vendimit. Pesha e asaj që përfaqëson.

Për vajzat e vitit 1967, kjo peshë ishte edhe më e veçantë, sepse ato ishin ndër të parat që hynin në këtë rrugë. Ato nuk kishin shumë modele para vetes. Duhej ta ndërtonin modelin vetë. Duhej të mësoheshin me një realitet të ri. Duhej të fitonin besimin e eprorëve. Duhej të dëshmonin se mund të përballonin stërvitjen dhe duhej të tregonin se gratë mund të ishin pjesë e strukturave ushtarake jo si një prani simbolike, por si profesioniste.

Kjo është një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë së tyre.

Mirënjohja për familjen, shkollën dhe shoqet

Liliana Konomi nuk e sheh suksesin e saj vetëm si rezultat individual. Në kujtimet e saj në takimet tona, mirënjohja ka një vend të veçantë. Ajo kujton prindërit, Andonta dhe Pandi Konomi, të cilët e rritën dhe e edukuan si qytetare, e mbështetën në zgjedhjen e profesionit dhe nuk ngurruan përballë një rruge që për kohën ishte e pazakontë.

Kujton shkollën dhe trupën pedagogjike e komanduese, të cilët kishin edhe ata një përvojë të re përballë vajzave që po përgatiteshin si oficere.

Dhe mbi të gjitha kujton shoqet. Ato 26 vajza të togës së këmbësorisë, me të cilat ndau dy vite të jetës, dy vite me mësime teorike, me stërvitje, me marshime, me provime, me seminare, me fusha stërvitjeje, me aktivitete artistike, me lodhje, me të qeshura, me vështirësi. Por edhe me solidaritet.

Kjo është ndoshta arsyeja pse, pas kaq shumë vitesh, ajo ende i kujton me kaq shumë ngrohtësi.

Sepse koha mund të marrë shumë gjëra.

Por nuk merr dot lehtë ato miqësi që janë krijuar në vështirësi.

Një grua që nuk e ka mbyllur kapitullin e shërbimit

Sot Liliana Konomi Mero është larg ditëve kur vishte për herë të parë uniformën dhe hynte në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Por largimi nga uniforma nuk do të thotë largim nga përgjegjësia shoqërore.

Përkundrazi, për njerëz si ajo, shërbimi nuk përfundon me daljen në pension apo me mbylljen e një detyre. Ai vazhdon në një formë tjetër, vazhdon përmes kujtesës, përmes rrëfimit, përmes takimeve, përmes kontributit në jetën shoqërore, përmes përcjelljes së përvojës, përmes mbështetjes së brezave të rinj. Dhe kjo është një formë tjetër shërbimi, një shërbim që nuk kërkon më rreshtim, por kërkon kujtesë, nuk kërkon komandë, por kërkon fjalë, nuk kërkon uniformë, por kërkon përgjegjësi. Sot, kur flasim gjithnjë e më shumë për rolin e gruas në Forcat e Armatosura, përfaqësimi i saj në strukturat ushtarake dhe për zhvillimin profesional të grave në uniformë, kujtime të tilla marrin një vlerë të veçantë. Sepse historia e grave në uniformë nuk fillon sot. Ajo ka rrënjë, dhe një pjesë e këtyre rrënjëve janë pikërisht ato 27 vajza që në shtatorin e vitit 1967 hynë në një shkollë ushtarake për të provuar një rrugë që për to ishte e re dhe e panjohur.

Një histori që nuk duhet të mbetet vetëm kujtim

Ka një arsye pse kujtimet e Liliana Konomit meritojnë të dëgjohen. Sepse ato nuk flasin vetëm për një grua. Flasin për një brez. Flasin për një periudhë të Forcave të Armatosura. Flasin për mënyrën se si gratë nisën të hynin në një profesion që për shumë vite ishte parë kryesisht si profesion burrash. Flasin për miqësinë, për disiplinën, për shkollimin, për stërvitjen, për sakrificën dhe mbi të gjitha flasin për njeriun brenda uniformës. Kjo është ajo që e bën një kujtim të vlefshëm, sepse pas çdo uniforme ka një histori, pas çdo grade ka një përpjekje, pas çdo detyre ka një familje, pas çdo karriere ka njerëz që kanë ndihmuar dhe pas çdo brezi ka një brez tjetër që duhet të mësojë prej tij.

Prandaj, rrëfime si ai i Liliana Konomit nuk duhet të mbeten vetëm në kujtesën personale.

Ato duhet të ruhen.
Të dokumentohen.
Të botohen.
Të lexohen nga brezat e rinj të ushtarakëve.

Sepse një ushtri nuk ndërtohet vetëm me armatim, teknologji dhe kapacitete.

Ndërtohet edhe me kujtesë institucionale.

Dhe kujtesa institucionale nuk lind vetvetiu.

Ajo ndërtohet nga njerëzit që kanë shërbyer dhe që pranojnë ta tregojnë historinë e tyre.

Nga një vajzë që doli vullnetare, te një grua që vazhdon të shërbejë me kujtesë

Në vitin 1967, Liliana Konomi ishte një vajzë maturante. Ajo nuk e dinte se çfarë do të sillnin vitet. Ndoshta nuk e imagjinonte se do të bëhej pedagoge.

Se do të komandonte një togë. Se do të punonte në botime. Se do të jepte mësim. Se do të merrte një dekoratë si "Naim Frashëri". Se një ditë do të ulej për të shkruar kujtimet e asaj vajze që udhëtoi me një kamion nga Malësia e Madhe drejt Tiranës, pa e ditur mirë se çfarë e priste.

Por ajo bëri një zgjedhje dhe e ndoqi atë zgjedhje me përkushtim. Sot, pas dekadash, ajo vazhdon të japë kontributin e saj në jetën shoqërore dhe në ruajtjen e kujtesës së jetës ushtarake. Ndoshta ky është edhe kuptimi më i bukur i një jete në shërbim. Të mos mbarojë gjithçka me ditën kur dorëzon uniformën. Sepse uniforma hiqet, por përvoja mbetet, dija mbetet, miqësitë mbeten, kujtimet mbeten dhe, mbi të gjitha, mbetet përgjegjësia për t'ua përcjellë brezave atë që ke jetuar.

Liliana Konomi Mero është sot pjesë e kësaj kujtese

Një prej atyre grave që nuk u mjaftuan të shihnin nga larg historinë e grave në uniformë, por u bënë pjesë e saj. Ajo ishte aty kur rruga sapo hapej. Ishte aty kur 27 vajza u bënë një togë. Ishte aty në klasë dhe në terren, në stërvitje dhe në auditor, në komandë dhe në pedagogji, në botime dhe në përgatitjen e brezave. Dhe sot, kur e kthen kokën pas, nuk sheh vetëm një karrierë, sheh njerëzit, sheh shoqet, sheh Teftën, sheh Lushin, sheh 27 vajzat; sheh prindërit, sheh pedagogët sheh Shkollën, sheh atë kamion që zbriste nga Leqet e Hotit dhe ndoshta, mbi të gjitha, sheh një vajzë të re që atëherë nuk e dinte sa e gjatë do të ishte rruga.

Por që pati guximin të thoshte: "**Po, unë do të shkoj.**"
Dhe shkoi.
Rruga ishte e vështirë.
Por ishte rruga e saj.

Dhe pas gjithë këtyre viteve, ajo rrugë vazhdon të ketë një kuptim të veçantë: shërbimi ndaj vendit nuk përfundon gjithmonë me uniformën; ai vazhdon edhe atëherë kur uniforma mbetet një kujtim, ndërsa përvoja bëhet një pasuri për brezat.



LUFTËTARË TË RËNË NË BETEJËN PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS

Atdheu përjetë mirënjohës!



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ


Sose Musa Memushaj


Rustem Ruza Memushaj

Çifti Memushaj ra për lirinë e Atdheut

Sose Musa Memushaj lindi në vitin 1924, në fshatin Bolenë, në një familje me tradita atdhetare. E rritur në frymën e dashurisë për vendin dhe të qëndresës ndaj pushtuesve, ajo u bë pjesë e veprimtarisë antifashiste që në moshë të re. Në vitin 1942 u martua me Rustem Riza Memushajn, nga Bolena, familja e të cilit ishte e njohur për traditat patriotike dhe mbështetjen ndaj Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Shtëpia e Memushajve ishte kthyer në një bazë të rëndësishme të LANÇ-it. Aty strehoheshin materiale luftarake të Brigadës VIII Sulmuese, si dhe materiale të punishtes ushtarake të prapavijës. Për këtë veprimtari, shtëpia e familjes u dogj nga pushtuesit. Sosja gjeti te bashkëshorti jo vetëm shokun e jetës, por edhe bashkudhëtarin e të njëjtit ideal: luftën për çlirimin e vendit. Ajo u aktivizua në Organizatën e Gruas Antifashiste të Bolenës, duke dhënë ndihmesën e saj në mbështetje të luftës.

Rustem Memushaj, që nga fundi i dhjetorit 1942, u bë pjesëtar aktiv i çetës territoriale vullnetare të fshatit Bolenë. Mori pjesë në aksione e luftime të ndryshme, ndër të cilat në Gjorm, Borsh dhe në përballimin e Operacionit të Dimrit 1943-1944. Një pasdite, Rustemi u kthye në shtëpi me nxitim. Mori pushkën, nxori nga arka fishekët dhe disa bomba dore, i vendosi në trastën që mbante gjithnjë me vete dhe nisi të përgatitej për t'u larguar. Sosja e vuri re shqetësimin e tij.

- Si shumë i vërejtur qenke sot! – i tha, duke mos ia ndarë sytë. Rustemi e pa me mendim, i buzëqeshi dhe iu përgjigj: - Dëgjo, sonte çeta territoriale e fshatit tonë do të niset për në luftë. Në drejtim të grykës së Shushicës janë nisur forca të mëdha italiane, me urë zjarri në dorë, për t'i vënë flakën Labërisë sonë.

- Udhë e mbarë dhe pushka top! – i uroi Sosja. Në fund të marsit 1944, në Bolenë mbërriti lajmi për formimin e Brigadës VIII Sulmuese. Shumë të rinj të fshatit, ndër ta edhe Rustemi, u rreshtuan në formacionin e ri partizan. Para nisjes, ai u kthye në shtëpi dhe e gjeti Sosen duke bërë bukë në magje. - Sose, nesër do të nisem me disa shokë për në brigadën partizane, – i tha. Ajo ngriti kokën dhe e dëgjoi me vëmendje. - Të vaftë mbarë, Rustem! Ai e kuptoi menjëherë se edhe ajo dëshironte të bëhej pjesë e luftës. - Të kuptova, Sose. Do të bëj çmos të gjej rastin të vij e të të marr edhe ty. - Unë do të pres, – iu përgjigj ajo.

Por Rustemi nuk u kthye më në Bolenë. Sosja, megjithatë, nuk hoqi dorë nga vendimi i saj. Rasti iu krijua më 1 korrik 1944, kur në fshat mbërriti një grup partizanësh të Brigadës VIII Sulmuese, të cilët sollën të plagosur partizanin Razo Zeneli. Ai ndërroi jetë dhe u shpall Dëshmor i Atdheut.

- Do të vij edhe unë me ju, – u tha partizanëve Sosja, – sepse kam edhe bashkëshortin në brigadë. Kështu, ajo u nis bashkë me ta, duke përshkuar male e gryka, derisa gjeti Brigadën VIII Sulmuese në Zagori të Gjirokastrës. Komanda e mirëpriti partizanen e re dhe e caktoi në kompaninë e tretë të batalionit të tretë.

Kur brigada po kalonte lumin e Vjosës, në drejtim të zonës së Beratit, Sosja dalloi mes partizanëve të batalionit të parë bashkëshortin e saj. - Sose! – thirri Rustemi. Ai qëndroi për një çast i shtangur, duke e parë me habi, sikur të mos u besonte syve. - Po, Rustem, unë erdha! - Tani do të luftojmë të dy së bashku! – iu përgjigj ai.

Takimi i tyre ishte një çast i veçantë gëzimi në jetën e vështirë partizane. Sosja u dallua për shkathtësi, guxim dhe përkushtim. Ajo u bë një aktiviste e mirë e Organizatës së Rinisë dhe u zgjodh përgjegjëse e rinisë në kompaninë ku bënte pjesë.

Brigada VIII Sulmuese mori detyrën nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së për të qenë një nga njësitë që do të luftonin për çlirimin e kryeqytetit. Në ditët e para të nëntorit 1944, ajo u vendos në kodrat e Saukut dhe të Sharrës dhe, pas marrjes së urdhrit luftarak, hyri në luftime.

Më 11 nëntor, kompania ku luftonte Sosja kishte çliruar një pjesë të kazermave të Ali Rizait. Gjermanët ndërmorën kundërsulme të fuqishme për të rimarrë pozicionet e humbura. Artileria armike godiste pa pushim pozicionet partizane. Kodrat u mbuluan nga tymi dhe flakët, ndërsa luftimet zhvilloheshin me ashpërsi të madhe.

Gjatë përleshjeve, një copë predhe e goditi Sosen në shpatull. Ajo nuk mundi të tërhiqej. Pak më vonë, një predhë tjetër shpërtheu fare pranë saj. Shokët vrapuan drejt saj, por Sosja nuk fliste më. Kishte dhënë jetën në luftën për çlirimin e Tiranës. Atë ditë, nga e njëjta kompani, ranë edhe dy partizanë të tjerë: Pasho Mehmeti dhe Sabri Serani. Kujtimi i tyre përjetësohet nga lapidari i ngritur në vendin ku ranë.

Rustem Memushaj vazhdoi luftën deri në çlirimin e Tiranës. Dhimbjen për humbjen e bashkëshortes e mbarti në zemër, por nuk u shkëput nga detyra luftarake. Me Brigadën VIII Sulmuese vijoi marshimin dhe luftimet deri në Vishegrad të Bosnjës.

Edhe pas çlirimit, Rustemi vazhdoi të shërbente në radhët e formacioneve partizane. Në detyrën e komisarit të kompanisë, më 31 gusht 1945, ra në Lezhë, gjatë luftimeve për mbrojtjen e pushtetit të vendosur pas çlirimit.

Kështu, familja Memushaj i dha luftës dy bashkëshortë, të cilët nuk u ndanë në idealin e tyre për lirinë e Atdheut. Sosja ra në betejën për çlirimin e kryeqytetit, ndërsa Rustemi dha jetën në muajt e parë pas çlirimit. Historia e tyre mbetet një dëshmi prekëse e sakrificës së njerëzve që vunë idealin e lirisë mbi jetën e tyre.

Sose Musa Memushaj është shpallur Dëshmore e Atdheut me vendimin nr. 97, datë 22.9.1972, të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Vlorë. Rustem Riza Memushaj (1923-1945), partizan i Brigadës VIII Sulmuese, është shpallur Dëshmor i Atdheut me të njëjtin vendim, nr. 97, datë 22.9.1972, të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Vlorë.

Partizania nga Mezhgorani që ra në Tiranë

Male Xheladin Bonaj lindi në vitin 1929, në fshatin Mezhgoran të Tepelenës, në një familje të thjeshtë me tradita atdhetare. Babai i saj, Xheladini, ishte burrë i urtë, punëtor dhe i fjalës. Ai ishte ndër të parët që iu përgjigj thirrjes për të luftuar në çetën e Mezhgoranit gjatë Luftës së Vlorës të vitit 1920. Në këtë mjedis familjar, ku dashuria për Atdheun dhe qëndresa ishin vlera të çmuara, u rrit dhe u edukua edhe Maleja. Që e vogël, ajo pa nga afër vështirësitë dhe pasojat e luftës. Në fshatin e saj zhvilloheshin përplasje ndërmjet ushtrive të huaja italiane dhe greke, ndërsa popullsia përjetonte pasigurinë dhe vuajtjet e pushtimit.

Megjithëse ende e re në moshë, Maleja u aktivizua me rininë e fshatit. Ajo ndihmoi në grumbullimin dhe transportimin e materialeve që nevojiteshin për luftën. Rënia e Heroit Asim Zeneli në Mezhgoran u bë një ngjarje me ndikim të madh te të rinjtë dhe të rejat e zonës, duke nxitur më tej angazhimin e tyre antifashist. Maleja ishte ende e parritur për t'u rreshtuar në formacionet partizane, por vendosmëria e saj për të marrë pjesë në luftë po rritej.


Male Xheladin Bonaj

Në prill 1944, së bashku me një grup të rinjsh nga Mezhgorani dhe Tepelena, ajo u rreshtua partizane në Brigadën VIII Sulmuese. Në radhët e brigadës mësoi përdorimin e armës dhe u dallua për përkushtim e guxim në luftimet ku mori pjesë.

Batalioni i katërt, ku bënte pjesë edhe Maleja, zhvilloi luftime të ashpra dhe përballoi Operacionin Armik të Qershorit 1944, në zonën Mali i Nëmërçkës-Ura e Petranit-Përmet. Ai u përfshi gjithashtu në përballimin e operacionit gjerman "Uhu", duke çarë rrethimin armik në drejtimin Qafa e Dhëmblanit-Mali i Poliçanit-Mali i Papingut.

Maleja mori pjesë edhe në luftime kundër garnizonit armik në qytetin e Gjirokastrës dhe në Lazarat, në luftimet për çlirimin e Konispolit, në mbrojtjen e Beratit gjatë shtatorit dhe tetorit 1944, si dhe në operacionin për çlirimin e Tiranës. Në këtë operacion, Brigada VIII Sulmuese kishte marrë detyrën të kalonte në mësymje në sektorin Selitë e Vogël–Yzberisht. Më 12 nëntor 1944, batalioni i katërt, ku luftonte edhe Male Bonaj, lëvizi drejt veriut dhe sulmoi pallatet e aviacionit e të xhenios, si dhe zonën e Fushës së Druve, në të dy anët e Lanës, në Tiranën e Re.

Për të ndalur përparimin e partizanëve, gjermanët sollën përforcime të shumta, përfshirë katër tanke, autoblinda dhe artileri. Luftimet u zhvilluan me ashpërsi të madhe dhe vazhduan deri në mëngjesin e 13 nëntorit. Forcat gjermane pësuan humbje dhe u tërhoqën në drejtim të Rrugës së Kavajës dhe qendrës së kryeqytetit.

Pasditen e 13 nëntorit, sektori i mësymjes së batalionit të katërt në Tiranën e Re u spastrua nga forcat armike. Por fitorja u arrit me sakrifica të rënda. Në luftimet e ashpra, në përleshje deri në afërsi trup më trup me armikun, ranë partizani Rakë Selami, nga Sevasteri i Vlorës, dhe partizania Male Xheladin Bonaj, nga Mezhgorani i Tepelenës. Pesë partizanë të tjerë mbetën të plagosur. Male Bonaj ishte vetëm 15 vjeçe kur dha jetën për çlirimin e kryeqytetit. Ajo mbetet një nga vajzat e reja që u rreshtuan në Brigadën VIII Sulmuese dhe e paguan me jetën e tyre ëndrrën për një Shqipëri të lirë.

Ra si fajkua dy ditë para çlirimit të kryeqytetit

Ali Xhemal Zhupa lindi në vitin 1913, në fshatin malor të Salarisë së Tepelenës, në një mjedis ku jeta ishte e vështirë dhe natyra e ashpër. Dimrat e gjatë, dëbora dhe acari, rrugët e gurta dhe mungesa e kushteve të jetesës e shoqëruan që në fëmijëri. Jeta nuk i kurseu vështirësitë. Që në moshë të re, këmbëzbathur e nëpër gurë e harca, u detyrua të punonte si hyzmeqar te të tjerët, duke u kujdesur për bagëtitë dhe duke përballuar varfërinë. Këto përvoja e kalitën karakterin, i forcuan vullnetin dhe i shtuan dëshirën për një jetë më të mirë.

Me pushtimin fashist, urrejtja ndaj okupatorëve dhe vendosmëria për të luftuar kundër tyre u bënë pjesë e ndërgjegjes së tij. Për veprimtarinë antifashiste u spiunua nga bashkëpunëtorët e pushtuesve dhe u arrestua nga autoritetet italiane. U dënua dhe vuajti nëntë muaj burg, por nuk u thye. Edhe gjatë shërbimit të detyrueshëm ushtarak, Aliu nuk hoqi dorë nga bindjet e tij. Së bashku me disa shokë, u arratis nga shërbimi, duke marrë me vete edhe armët. Që nga ajo kohë u përfshi në aksione të ndryshme kundër pushtuesve. Në bashkëpunim me shokët e tij, mori pjesë edhe në hedhjen në erë të urës mbi përroin e Salarisë.


Ali Xhemal Zhupa

Në luftimet e Dukajt u plagos rëndë, por kjo nuk e largoi nga rruga e nisur. Pasi u shërua, u kthye sërish në radhët partizane, duke u rreshtuar në Brigadën VIII Sulmuese. Ishte ndër ata luftëtarë që, pavarësisht plagëve dhe vështirësive, qëndronin në ballë të aksioneve dhe luftimeve. Gjatë veprimtarisë luftarake të brigadës mori pjesë në shumë beteja. Në çdo përballje tregoi guxim dhe vendosmëri, duke u bërë pjesë e atyre luftëtarëve që nuk tërhiqeshin përballë rrezikut.

Në nëntor 1944, Brigada VIII Sulmuese u angazhua në luftimet për çlirimin e Tiranës. Ali Xhemal Zhupa ishte ndër luftëtarët që morën pjesë në sulmin kundër kazermave "Shkumbini". Aty, në përleshjet e ashpra me forcat gjermane, më 15 nëntor 1944, vetëm dy ditë para çlirimit të plotë të kryeqytetit, ai dha jetën. Ra në pragun e fitores, në një nga betejat vendimtare për çlirimin e Tiranës. Ra si luftëtar që kishte përballuar varfërinë, burgun, plagët dhe rreziqet e luftës, pa u shkëputur nga ideali për të cilin ishte ngritur në këmbë. Ali Xhemal Zhupa mbetet në kujtesën e historisë si një nga luftëtarët e Brigadës VIII Sulmuese që dhanë jetën në ditët e fundit të betejës për çlirimin e kryeqytetit.



Toka po ndryshon më shpejt se sa mendojmë

Sinjalet shqetësuese që shkencëtarët po vëzhgojnë në planetin tonë

Toka është rreth 4.54 miliardë vjeçare dhe gjatë gjithë historisë së saj ka kaluar transformime të jashtëzakonshme. Kontinentet janë ndarë e bashkuar, oqeanet janë hapur e mbyllur, akullnajat kanë avancuar e janë tërhequr dhe fusha magnetike që mbron jetën në planet ka ndryshuar vazhdimisht. Mirëpo sot, shkencëtarët po vëzhgojnë një sërë fenomenesh që tregojnë se planeti ynë po kalon ndryshime të rëndësishme, disa prej të cilave mund të kenë pasoja të drejtpërdrejta për jetën moderne.

Nga dobësimi i mburojës magnetike të Tokës dhe ngadalësimi i rrymave oqeanike, deri te zhvendosja e poleve magnetike dhe përshpejtimi i rotacionit të planetit, sinjalet që vijnë nga kërkimet shkencore tregojnë se bota jonë është në një gjendje ndryshimi të vazhdueshëm. Pyetja që shtrojnë gjithnjë e më shpesh shkencëtarët është: sa të shqetësuar duhet të jemi?

Mburoja e padukshme e Tokës po dobësohet

Një nga fenomenet që ka tërhequr vëmendjen e komunitetit shkencor është dobësimi gradual i fushës magnetike të Tokës. Kjo fushë, e krijuar nga lëvizjet e hekurit të shkrirë në bërthamën e planetit, vepron si një mburojë gjigante që mbron Tokën nga era diellore dhe rrezatimi kozmik. Pa këtë mbrojtje, grimcat energjetike të lëshuara nga Dielli do të dëmtonin atmosferën dhe do ta bënin jetën në sipërfaqen e planetit shumë më të vështirë.

Sipas vëzhgimeve të NASA-s, forca mesatare e fushës magnetike globale është ulur me rreth 9 për qind gjatë dy shekujve të fundit. Ky proces nuk ka ndodhur në mënyrë të barabartë në të gjithë planetin. Një nga zonat më problematike është e ashtuquajtura Anomalia e Atlantikut Jugor, një rajon që shtrihet midis Amerikës së Jugut dhe Afrikës. Shkencëtarët e konsiderojnë këtë zonë si një "pikë të dobët" në mburojën magnetike të Tokës.

Një kërcënim për satelitët dhe astronautët

Anomalia e Atlantikut Jugor po zgjerohet gradualisht dhe po lëviz drejt perëndimit. Brenda saj, rripi i rrezatimit *Van Allen* afrohet më shumë me sipërfaqen e planetit sesa në çdo rajon tjetër. Kjo nënkupton se satelitët që kalojnë nëpër këtë zonë ekspozohen ndaj niveleve më të larta të rrezatimit kozmik. Pasojat mund të jenë serioze.

Sistemet elektronike të satelitëve mund të pësojnë defekte të përkohshme ose edhe dëmtime të përhershme. Në rastet më të rënda, mund të preken shërbime jetike si navigimi GPS, komunikimet satelitore dhe parashikimet meteorologjike. Për astronautët, ekspozimi i shtuar ndaj rrezatimit përbën gjithashtu një sfidë serioze për sigurinë e misioneve hapësinore.

Vorbulla polare po ndryshon sjellje

Një tjetër fenomen që ka shqetësuar meteorologët është ndryshimi i sjelljes së vorbullës polare. Vorbulla polare është një zonë e madhe me presion të ulët dhe ajër shumë të ftohtë që rrethon polet e Tokës. Tradicionalisht, ajo qëndron relativisht e qëndrueshme mbi Arktik, duke mbajtur masat e ftohta të ajrit të përqendruara në veri.

Por vitet e fundit kjo strukturë atmosferike është bërë më e paqëndrueshme. Kur vorbulla polare zgjatet ose dobësohet, masa të mëdha ajri arktik përhapen drejt jugut. Pikërisht ky fenomen është lidhur nga ekspertët me dimrat ekstremë që kanë goditur Kanadanë dhe Shtetet e Bashkuara gjatë viteve të fundit. Temperatura rekord të ulëta, stuhi dëbore dhe valë të ftohti të pazakonta janë bërë dukuri gjithnjë e më të shpeshta.

Rrymat oqeanike që kontrollojnë klimën po ngadalësohen

Ndër sinjalet më alarmante që vijnë nga shkenca moderne është dobësimi i qarkullimit oqeanik në Atlantik. Sistemi i njohur si AMOC (Atlantic Meridional Overturning Circulation) funksionon si një rrip transportues gjigant që shpërndan nxehtësinë nëpër oqeane. Falë tij, rajone të mëdha të planetit ruajnë ekuilibrin klimatik.

AMOC transporton ujë të ngrohtë nga tropikët drejt Atlantikut Verior dhe rikthen ujërat më të ftohta në drejtim të kundërt. Ky mekanizëm ndikon drejtpërdrejt në temperaturat, reshjet dhe nivelin e detit në shumë pjesë të botës. Megjithatë, studime të shumta sugjerojnë se sistemi po dobësohet, pjesërisht si rezultat i ndryshimeve klimatike dhe shkrirjes së akujve.

Çfarë do të ndodhte nëse AMOC do të shembej?

Pasojat potenciale do të ishin globale. Modelet kompjuterike tregojnë se një kolaps i qarkullimit AMOC mund të shkaktonte rritje të konsiderueshme të nivelit të detit përgjatë brigjeve të Atlantikut. Në Shtetet e Bashkuara, studiuesit kanë vërejtur se një pjesë e madhe e përmbytjeve përgjatë bregdetit verilindor është e lidhur me dobësimin e këtij sistemi oqeanik.

Por ky do të ishte vetëm fillimi. Ndryshime të mëdha do të mund të ndikonin ciklet klimatike globale, reshjet atmosferike, bujqësinë dhe madje ekosistemin e Amazonës, një nga rezervuarët më të mëdhenj të biodiversitetit në planet.

Polet e Tokës po lëvizin

Edhe polet magnetike të Tokës nuk janë statike. Shkencëtarët kanë dokumentuar prej dekadash se Poli Magnetik Verior lëviz me një shpejtësi shumë më të madhe sesa Poli Magnetik Jugor. Arsyeja kryesore lidhet me lëvizjet e vazhdueshme të hekurit dhe nikelit të shkrirë në bërthamën e jashtme të Tokës, proces që krijon fushën magnetike planetare.

Por një faktor tjetër ka habitur studiuesit. Rezervuarët gjigantë të ndërtuar nga njeriu kanë grumbulluar aq shumë ujë sa kanë ndikuar në shpërndarjen e masës së planetit. Disa studime sugjerojnë se pesha e ujit të depozituar në diga ka kontribuar në zhvendosjen e poleve me më shumë se një metër.

Një oqean i ri po lind në Afrikë

Ndërkohë, në Afrikën Lindore po zhvillohet një proces gjeologjik që mund të ndryshojë hartën e botës. Nën rajonin Afar të Etiopisë, shkencëtarët kanë identifikuar lëvizje të mëdha të materialit të shkrirë nga manteli i Tokës. Ky proces po shkakton ndarjen graduale të pllakave tektonike afrikane. Nëse ky evolucion vazhdon sipas parashikimeve aktuale, pas dhjetëra miliona vitesh aty mund të formohet një oqean i ri, i lidhur me Gjirin e Adenit dhe Detin e Kuq. Edhe pse ky proces është tepër i ngadaltë në shkallën njerëzore, ai tregon se sipërfaqja e Tokës vazhdon të transformohet edhe sot.

Shkëmbinjtë e rinj të krijuar nga njerëzit

Jo të gjitha ndryshimet e planetit janë natyrore. Gjeologët kanë zbuluar një lloj të ri formacioni të quajtur shkëmb antropoklastik, i cili krijohet nga aktiviteti njerëzor. Studiues nga Universiteti i Glasgow-s gjetën në depozita industriale objekte të viteve 1930, përfshirë një kanaçe alumini dhe një monedhë, tashmë të "burgosura" brenda strukturave shkëmbore. Këto materiale industriale përmbajnë minerale shumë reaktive që përshpejtojnë procesin e ngurtësimit. Rezultati është i jashtëzakonshëm: shkëmbinj që formohen brenda dekadave, në vend të mijëra apo miliona viteve që kërkon zakonisht cikli natyror gjeologjik.

Afrika e Jugut po ngrihet

Një tjetër fenomen interesant është ngritja graduale e territorit të Afrikës së Jugut.

Matjet tregojnë se disa zona të vendit po ngrihen me disa milimetra çdo vit. Studiuesit besojnë se procesi lidhet me një fryrje të kores së Tokës e njohur si "hotspoti Quathlamba". Megjithëse ndryshimi është i vogël nga viti në vit, ai dëshmon se planeti vazhdon të jetë gjeologjikisht aktiv.

Ari po rrjedh nga bërthama e Tokës

Një nga zbulimet më intriguese të viteve të fundit lidhet me metalet e çmuara të fshehura në zemrën e planetit. Bërthama e Tokës përmban rreth 99.95 për qind të arit të planetit. Për miliarda vite është besuar se këto rezerva janë të izoluara në thellësi të paarritshme.

Megjithatë, gjeokimistët kanë gjetur gjurmë të metaleve të rralla në shkëmbinjtë vullkanikë të Havait, duke sugjeruar se materiale nga bërthama mund të depërtojnë gradualisht në mantel dhe më pas drejt sipërfaqes. Ky proces mund të ofrojë informacion të ri rreth dinamikës së brendshme të Tokës.

Ditët po bëhen më të shkurtra

Ndoshta ndryshimi më i çuditshëm lidhet me vetë kohën. Që nga viti 2020, shkencëtarët kanë vërejtur se Toka po rrotullohet pak më shpejt se zakonisht. Ndryshimi është minimal dhe nuk perceptohet nga njerëzit, por matjet me orët atomike tregojnë se disa ditë janë bërë fraksione sekondash më të shkurtra. Arsyet mbeten ende të paqarta.

Pozicioni i Hënës, ndikimi gravitacional i Diellit, lëvizjet në bërthamën e Tokës dhe ndryshimet në shpërndarjen e masës së planetit janë ndër faktorët që mund të luajnë rol. Megjithatë, shkencëtarët ende nuk kanë një shpjegim përfundimtar se përse planeti ynë po fiton gradualisht shpejtësi.

Një planet që nuk ndalet kurrë së ndryshuari

Shumica e këtyre proceseve zhvillohen në periudha kohore shumë më të gjata sesa jeta e njeriut. Megjithatë, disa prej tyre, si dobësimi i fushës magnetike, ndryshimet klimatike apo ngadalësimi i rrymave oqeanike, mund të kenë pasoja të prekshme brenda këtij shekulli.

Ajo që është e sigurt është se Toka nuk është një botë statike. Nën këmbët tona, në oqeane, në atmosferë dhe në bërthamën e saj të zjarrtë, planeti po ndryshon pa pushim.

Ndërsa shkenca zbulon gjithnjë e më shumë sekrete për mënyrën se si funksionon kjo makineri gjigante kozmike, një gjë bëhet e qartë: të kuptosh evolucionin e Tokës nuk është thjesht një ushtrim akademik. Është çelësi për të kuptuar të ardhmen tonë në planetin që e quajmë shtëpi.



UNË JAM MIRË
kur asht mirë Shqipnia!